Rruga Arbërit

GAZETË E PAVARUR. NR. 7 (39). KORRIK 2009. ÇMIMI: 50 LEKË. 20 DENARË. 1.5 EURO

AURORA GROUP SH.P.K.

PROJEKTIM - ZBATIM

koha kalon, cilësia mbetet

Autostrada Tirane - Durres, Km.9
Tel: +355 48 30 2046
Tel: +355 48 30 2040
www.auroragroup.com.al
e-mail: auroragroup@auroragroup.com.al

BOTIME

Një tezë e re për vendorigjinën e Skënderbeut

Nga: **XHAFER MARTINI** - FAQE 13

REPORTAZH

Magjia e imazhit për perlat e Rekës së Epërme

Nga: **ATLI DEMA** - FAQE 6

INTERVISTË

Dashuria që lindi nga një libër anatomie

Me mjeken dermatologe **Monika Fida (Zebi)** - Faqe 10

SHENIM

Kush janë xhonturqit e sotëm?

Nga: **BUJAR KAROSHI**

Në fund të janarit të këtij viti m'u desh të shoqëroja kryetarin dhe nënkryetarin e shoqatës "Bashkësia Dibrane", Arian Kadiu dhe Hazis Ndregjoni, si dhe kryetarin e Shoqatës LID, Prof. Dr. Nuri Abdiun, në një takim në Dibër të Madhe.

Përfaqësuesit nga Tirana do të takoheshin me 31 janar në Dibër me kryetarin e Komunës, Argëtim Fida, si dhe disa bashkëpunëtorë të tij, të cilët do të merreshin me organizimin e festimeve për nder të 100 vjetorit të Kongresit të Dibrës, mes të cilëve Myftiu i Dibrës, Mr. Ruzhdi Lata, kryetarin e këshillit komunal Nizamedin Papraniku si dhe Prof. Dr. Mahmud Hysa.

Qëllimi këtij takimi ishte bashkërendimi i punëve për të festuar 100-Vjetorin e Kongresit të Dibrës, në korrik të vitit 2009. Sipas përfaqësuesve nga Tirana, këto festime do të zgjasnin 1 javë dhe do të organizoheshin në tre qytete: Tiranë, Dibër dhe Peshkopi. Qëllimi i takimit ishte koordinimi i datave, në mënyrë që të mos kishte përplasje dhe veprimtaritë të ishin masive dhe të mirëorganizuara.

Dr. Argëtim Fida, tha në atë takim se "Komuna e Dibrës së Madhe dhe Qeveria e Maqedonisë kanë shprehur interesim dhe gatishmëri për mbështetjen e këtij manifestimi".

Ndërkaq, përfaqësuesit nga Tirana theksuan se kanë sinjale pozitive dhe shpresojnë se edhe Qeveria e Shqipërisë do ta mbështesë këtë manifestim.

Shoqata "Bashkësia Dibrane" ishte iniciatorja për organizimin e kësaj veprimtarie në Tiranë dhe shoqata "Lidhja e Intelektualëve Dibranë" e kishte mbështetur nismën. Madje, kjo e fundit kishte mbledhur disa herë kryesinë e saj, kishin miratuar një projekt masash dhe një program me propozime për kumtesat, për të cilin ishin informuar shoqata "Bashkësia Dibrane" edhe organizatorët, por që nuk u morën parasysh.

(Vijon në faqen 2)

E vërteta e Kongresit të Dibrës

Zhvillohet në Dibër të Madhe Konferenca Shkencore për 100-vjetorin



Në Kongresin e Dibrës më 23 korrik 1909 u mblodhën mbi 320 burra dhe Dibra plot gjashtë ditë, i mbajti, i mbrojti dhe i përcolli me tradita bujare, fisnike e mikpritëse. Në këtë Kongres xhonturqit i bënë hesapet pa hanxhinë pse menduan se Dibrën e kanë si në kafez. U doli krejtësisht e kundërta pse kuvendarët patriotë aprovuan edhe 12 pika tjera jashtë dëshirës së xhonturqve. Ky ishte shkaku që Stambolli urdhëroi ndërprerjen e Kongresit, por doli në skenë paria e Dibrës dhe e fshatrave që u çuan në këmbë, rrethuan shtëpinë e Kongresit, i siguruan delegatët dhe mundësuan që Kongresi t'i përfundojë punimet ashtu si ishte interesi i shqiptarëve patriotë. Në ditën e sotme para 100 viteve gjeti terren të përshtashëm diplomacia e Haxhi Vehbi Dibrës, që Kongresi t'i zhvillojë punimet siç ishte më së miri për çështjen shqiptare. U pranuan dhe fuqizuan kërkesat imediate të shqiptarëve për shtetin e parë të ardhshëm shqiptar. Dhe s'ka pse të mos krenohet sot Dibra me vendimet që u sollën në këtë Kongres, me triuffin e forcave patriotike dhe debaklin e atyre proqeveritare xhonturke. Aty morën pjesë patriotët më të dalluar të kohës nga të gjitha trojet e klubet shqiptare dhe jashta trojeve shqiptare si nga Stambolli, Kajro, Aleksandria, Selaniku, Follorina, Kosturi, Sofja, Velesi. Gjatë punimeve të Kongresit u përdor gjuha shqipe, u morën vendime për hapjen e shkollave shqipe, vendime ekonomike, juridike, fiskale, që shërbimi ushtarak të kryhet në trojet shqiptare, të hapen hekurudha, nëpunësit shterorë ta njohin gjuhën shqipe, kërkesa që de fakto ishin premise të shtetësisë.

Kur të gjithë dëshironin të gllabërohin tokat shqiptare Kongresi i Dibrës tregoi se as xhonturqit dhe as të tjerët nuk mundën ta mposhtin idenë e ndërtuar për shtetin, kombin, gjuhën dhe alfabetin që tani kanë mbetur realitet. Sot këtu jemi bashkë nga të gjitha trojet etnike dhe kështu bashkë duhet të hapërojmë me unitet shpirtëror, gjuhësor e kulturor, por edhe për një zhvillim ekonomik të përbashkët në një evropë të bashkuar...

"...Kongresi i Dibrës ishte një ngjarje me peshë në drejtimin e mëtejmë të lëvizjeve dhe përpjekjeve tona për çlirim, unitet, dinjitet dhe pavarësi kombëtare. Në mesazhin për politikën aktuale shqiptare në Tiranë, Shkup, Tetovë, Prishtinë, Ulqin, dhe bashkëkombasit tanë në Prevezë e Janinë, shton se, në disa pjesë të hartës së atdheut, liderët tanë politike duhet vënë gishtin në kokë, për gjuhën që përdorin ndaj njëri-tjetrit, për punën që për ditë e bëjnë. Duhet rënë në ujdi se përçarja, urrejtja mes tyre dhe lufta pakompromis e tyre që po bëjnë, çojnë ujin vetëm në mulli të huaj. Duhet të kemi unitet, sepse kemi shumë armiq rreth vetes..."

(Speciale në faqet 3,4,5,6,8)

VEPRIMTARI

Mirë se erdhe Iljaz Pashë Qoku!

Në qendër të qytetit të Peshkopisë, më 12 qershor 2009 u vendos busti i Iljaz Pash Qokut (Dibra), vepër kjo e skulptorit dibran, prof. Kadri Gjati, e financuar nga biznesmeni shqiptaro amerikanë, me banim në Nju Jork z. Ylber Pilku dhe familja e tij në Dibër të Madhe.

Nga: **BEQIR SINA** - FAQE 9



VENDLINDJA

KALAJA E DODËS

Nga: **NAIM PLAKU** - FAQE 7

DESHMI

Të dënuarit në krahinën e Çidhnës

Nga: **HAKI PERNEZHA** - FAQE 14

PROFIL

Bashkëshortë dhe afaristë të shkëlqyer

Shpresa dhe Mexhit Capa: "Objektiv yni, është ndërtimi edhe nga një hotel me pesë yje në Banisht dhe Kosovrast sëbashku me poligonet sportive rekreative"

Nga: **REXHEP TORTE** - FAQE 11

Posta e Rruga Arbërit

Gazetë e pavarur.
Nr. 7 (39). 1- 31 Korrik 2009

Redaksia e gazetës falënderon lexuesit dhe bashkëpunëtoret e saj për mesazhet dhe shkrimet e sjella për botim.

Redaksia u kujton bashkëpunëtorëve të saj, zotërinjve Isa Halilaj, Fejzulla Gjabri, Mahmud Hysa, Agron Tufa, Xhelal Roçi, Odise Plaku, Kujtim Boriçi, etj, se shkrimet e tyre, për arsye vendi nuk janë botuar në këtë numër.
Ato do të botohen në numrat e ardhshëm të gazetës "Rruga e Arbërit".

Kujtojmë bashkëpunëtorët, të cilët duan që shkrimet e tyre të botohen patjetër në numrin e radhës, të konfirmojnë më parë sjelljen e materialit në numrat e telefonit të redaksisë ose emailin e gazetës.
Shkrimet priten në redaksi deri më **datë 20** të muajit.
Gjithashtu, ju kujtojmë bashkëpunëtorëve se shkrimet deri në dy faqe daktilografike kanë përparësi botimi.
Gazeta publikohet falas në internet me datë 7 të muajit pasardhës

Ju falënderojmë që jeni pjesë e gazetës!


DREJTOR:
Rakip Suli

Këshilli Botues:
Musa Riçku
Shaqir Skarra
Bujar Karoshi

Bashkëpunuan në këtë numër:
Rexhep TORTE,
Naim PLAKU
Xhafer MARTINI
Atli DEMA
Beqir SINA
Haki PËRNEZHA
Zabit LLESHI
etj.

Adresa e gazetës:
Rr. "Zenel Baboçi",
Pall. "Ferar", Tiranë
Tel. +355 4 22 33 283
E-mail: rrugaearberit@gmail.com

Opinionet dhe komentet e botuara nuk shprehin domosdoshmërisht qëndrimin e redaksisë



Gjeneral Gëzim Ostreni titullohet Master në Shkenca Politike

Më 4 korrik 2009 në një nga sallat e Universitetit Ndërkombëtar të Strugës, u organizua mbrojtja e temës për titullin Master në Shkenca Politike, të Gjeneral Gëzim Ostrenit. Tema titullohej: "Liritë dhe të drejtat e shqiptareve në Maqedoni nga viti 1974 deri në vitin 2006" . E ndarë në disa kapituj tema paraqiste me të dhëna statistikore të drejtat e shqiptarëve në Maqedoni, përfaqësimi i tyre në parlament, në pushtetin qendror dhe vendor dhe të drejtat e arsimimit në gjuhën shqipe.

E trajtuar kryesisht në konceptin e lirive dhe të drejtave të njeriut, por në këndvështrimin e shkencave politike, autori mbrojti para komisionit dhe auditorit një studim shkencor me vlera kombëtare dhe politike. Pas pyetjeve dhe diskutimeve, komisioni e titulloi zotin Gëzim Ostreni, Master në Shkenca Politike. Në këtë aktivitet shkencor merrte pjesë edhe zoti Ali Ahmeti, deputetë dhe përfaqësues shqiptar në qeverinë dhe parlamentin e Mqedonisë. Zoti Gëzim Ostreni banon në Dibër të Madhe, është në pension pas një kontributi të gjatë në strukturat e shtetit dhe të politikës së Maqedonisë. Ai është një model për të gjithë brezat e rinj për të vazhduar pa pushim arsimimin personal, pavarësisht nga mosha.



Universiteti Ndërkombëtar i Strugës jep diplomat e para

Më 7 korrik 2009, në mjediset e Universitetit Ndërkombëtar të Strugës, u zhvillua ceremonia e dhënies së diplomave të para për studentët e këtij Universiteti. Në fjalën e rastit rektori Lisen Bashkurti, paraqiti objektivat dhe ecurinë e këtij universiteti si dhe uroi të diplomuarit e parë për suksese të mëtejshme në angazhimet e tyre për studime dhe në punë. Universiteti ka një rritje të vrullshme të numrit të studentëve nga Maqedonia dhe Shqipëria, është i akredituar nga qeveria e Maqedonisë dhe ka një staf akademik të nivelit të lartë. Universiteti ka katër fakultete si: Shkenca Ekonomike, Shkenca Juridike, Shkenca Politike dhe Shkenca Informatike si dhe tre institute. Në këtë ceremoni festive merrnin pjesë akademikë nga Maqedonia dhe Shqipëria, përfaqësues të qeverisë dhe parlamentit, nga pushteti vendor i komunës Strugë si dhe banorë të qytetit e prindër të të diplomuarve.

/ **Sh.Cami**

PËRSHËNDETJE

Respekt për delegatët e Kongresit



Përshëndetje e Prof. Nuri Abdiut në Akademinë Solemne, organizuar në Dibër të Madhe me rastin e 100-vjetorit të Kongresit të Dibrës (1909-2009)

Dibranët gjatë përpjekjeve të tyre të pareshtura, luftërave heroike për të mbijetuar, për ruajtjen e identitetit etnik, kombëtar krijuar edhe kulturën e traditën e vet. Burrat e ditur të Dibrës, duke mësuar nga përvoja e mendimi shkencor i vendit të tyre dhe i vendeve të tjera, janë përpjekur e kanë dhënë kontributin e tyre modest edhe në zhvillimin e kulturës dhe të dijes kombëtare dhe më gjerë.

Dihet se vlerat e një populli nuk mund të maten vetëm me kriteret materiale apo formulat e zhvillimit ekonomi dhe të ardhurat e njerëzve. Vlerat e një populli qëndrojnë po aq edhe tek historia e traditat e përcjella në brezat; kultura e pasur dhe figurat e tij.

Kështu ndodh edhe me vlerat e një krahine, siç është Dibra jonë e shtrenjtë, Dibra e Nëntë Maleve, e Shtatë Teqeve dhe Katër Oxhaqeve, e cila, në pozicionimin verilindor të Shqipërisë thonë se përbën një mrekulli të natyrës dhe një kështjellë të historisë. Ajo u shpalos si një nga trevat e nxehta të atdhedashurisë, kulturës kombëtare dhe zhvillimeve progresive në shekuj, në ditët tona dhe në vijim.

Dibranët i kanë pasur dhe i kanë në traditën e tyre tubimet, kuvendet, besëlidhjet e kongreset. E një ndër to është edhe Kongresi i Dibrës që na ka mbledhur sit në këtë Akademi Solemne, në të cilën, unë kam nderin të përshëndes në emër të Shoqatës LID në Tiranë dhe t'ju sjell urimet e tyre më të përzemërta në këtë ditë të shënuar me rëndësi historike, jo vetëm për Dibrën tonë, por për mbarë Kombin Shqiptar.

Kongresi i Dibrës, i mbajtur 100 vjet më parë, pikërisht në këtë qytet, në djepin e dijes e të trimërisë legjendare, të cilës edhe në ditët e sotme i këndohen këngët që mbajnë erë baroti e që ruajnë gjurmë gjaku; që dibranët nuk e kursyen asnjëherë në luftërat e tyre për liri e pavarësi. Kongresi i Dibrës, ndër të tjera, vuri në rend të ditës realizimin e vendimeve të Kongresit të Manastirit për gjuhën dhe për shkollën shqipe, shpalli kërkesat që do të çonin në jetësimin e autonomisë së vendit; kërkesat për nëpunës që dinin gjuhën shqipe dhe që njihnin e respektonin zakonet shqiptare, etj.

Unë, në emër të Shoqatës LID, nga kjo foltore e nderuar, përulem me respekt të veçantë në kujtim të emrave të të gjithë delegatëve të Kongresit që e treguan veten shqiptarë të vërtetë dhe qëndruan pa u epur përballë reaksionit xhonturk dhe atyre që e përkrahën atë. Me këtë rast, më lejoni të shpreh përnderime dhe homazhe për delegatët e atij Kongresi që nuk ishin nga Dibra, si: Hafis Ali Korça, Abdyl Ypi, Qenan Manastiri dhe gjithë të tjerëve.

SHENIM

Kush janë xhonturqit e sotëm?

(Vijon nga faqja 1)

Në Tiranë, një këshilltar i kryeministrit kishte garantuar se, sapo të kthehej Kryeministri nga Samiti i Davosit, do t'i paraqitej kërkesa e shoqatave dibrane dhe 99% kjo punë ishte e mbaruar, d.m.th, do të ishte vete qeveria që do të përfshihej në organizim, do të nxirrte fondet për këtë veprimtari, etj. Madje, për këtë ishte njoftuar edhe drejtori i Institutit të Historisë dhe gjithë kapacitetet e këtij institucioni do të viheshin në lëvizje. Kongresi i Dibrës do kujtohej siç nuk ishte kujtuar gjatë 99 viteve të kaluara...

Në atë bisedë gjithçka ishte e hapur dhe me frymë mirëkuptimi: përveç një detaji: Ku do të zhvillohej veprimtaria kryesore, ajo e datës 23!

Dërgata e Tiranës, sidomos kryetari i Shoqatës "Bashkësia Dibrane", këmbëngulte që 23-shi të bëhej në Tiranë, pasi ky mund të ishte një kusht nga Kryeministri i Shqipërisë, pasi të njihej me kërkesën, sapo të kthehej nga Davosi, natyrisht. Ndërsa kryetari i Komunës ishte luajal për datat, por 23-shin e kishte brenda, sigurisht. Ne do të bëjmë një organizim dyditor, - tha ai, por datat janë ose 22-23, ose 23-24... "Kongresi është zhvilluar më 23 në Dibër dhe me 23 do të festojmë në Dibër", - vuri veton ai dhe mirë bëri.

Na pritën e na mbajtën mirë dhe më 31 pasdite u kthyem për Tiranë....

Kryeministri erdhi nga Davosi... Pastaj iku në Uashington. U kthye edhe nga Uashingtoni dhe pas ca ditësh iku në Kroaci.... Më pas në Katar, në Bosnjë... Por vetëm pas gati tre muajsh, nga mesi i muajit prill, u mor vesh që qeveria shqiptare "nuk mund të merret me organizimin e veprimtarisë, pasi janë zgjedhjet përpara..." Pas kryeministrit u tërhoq edhe Instituti i Historisë... "Kongresi i Dibrës ishte vepër e Xhonturqve..."

Kështu kaluan ditët dhe muajt, 6 muaj prej atëherë, dhe java përkujtimore e Kongresit të Dibrës, me festime e veprimtari në Tiranë, Peshkopi e Dibër të Madhe u katandis në dy ditë në Dibër të Madhe... Nga Tirana shkuan a nuk shkuan dy furgona me pasagjerë, ca me ftesa e ca pa ftesa, për arsyen se edhe këto u grabitën rrugës... Edhe referuesit shkencorë nga Tirana, nga katër të planifikuar për të referuar, vetëm njëri u paraqit, Marenglen Verli, një tjetër, Gazmend Shpuza, nuk mundi të merrte pjesë, por të paktën referimin e tij gjeti mundësi ta çonte dorazi...

"Historia përsëritet", - thonë vetë historianët. Kongresin e Dibrës më 1909 e organizuan xhonturqit, por, pasi panë se nuk mund të ndikonin mbi vendimet e tij, u munduan ta sabotonin... Por në 100 vjetorin e përkujtimit të kësaj ngjarje të madhe, kush ishin xhonturqit?

B. KAROSHI

Nuri Abdiu: Dibranët i kanë pasur dhe i kanë në traditën e tyre tubimet, kuvendet, besëlidhjet e kongreset. Dibrës edhe në ditët e sotme i këndohen këngë që mbajnë erë baroti, që ruajnë gjurmë gjaku, që dibranët asnjëherë nuk e kursyen për në luftërat e tyre për liri e pavarësi.

Dibër - Përfundoi shënimi i 100- vjetorit të Kongresit të Dibrës

Kongresi i Dibrës, ditë historike për mbarë kombin shqiptar



Nga **REXHEP TORTE**



Ky manifestim filloi me shpalosjen e Pllakës ABC, simbol i përpjekjeve të popullit shqiptar për ta ruajtur dhe përdorur gjuhën shqipe.

Argëtim Fida: Kur të gjithë dëshironin të gllabëronin tokat shqiptare Kongresi i Dibrës tregoi se as xhonturqit dhe as të tjerët nuk mundën ta mposhtin idenë e ndërtuar për shtetin, kombin, gjuhën dhe alfabetin që tani kanë mbetur realitet. Sot këtu jemi bashkë nga të gjitha trojet etnike dhe kështu bashkë duhet të hapërojmë me unitet shpirtëror, gjuhësor e kulturor, por edhe për një zhvillim ekonomik të përbashkët në një evropë të bashkuar...

Nga: **REXHEP TORTE**

Më 23 dhe 24 korrik 2009 në Dibër të Madhe u shënua solemnisht 100-Vjetori i Kongresit të Dibrës" (1909-2009). I tëri qyteti ishte në festë për të përjetuar këtë data të madhe dibrane e mabarëkombëtare dhe për të pritur me mikëpritjen dibrane qindra mysafirë nga Shqipëria, Kosova, Maqedonia, diaspora si edhe bijtë, bijat, nipërit dhe mbesat e delegatëve që morën pjesë pjesë në këtë Kongres para 100 viteve.

Ky manifestim filloi me shpalosjen e Pllakës ABC, simbol i përpjekjeve të popullit shqiptar për ta ruajtur dhe përdorur gjuhën shqipe.

Argëtim Fida, kryetar i komunës së Dibrës së Madhe me këtë rast, theksoi se, "Me nismën e çiftit Jorgoni dhe me mbështetje të Komunës së Dibrës, sot inagurojmë bustin e ABC-së ose alfabetit shqip, me dëshirë që kësi bustash të inaurohen në të gjitha qytetet me shumicë shqiptare".

Fida, sëbashku me zv/kryeministrin Abdilaqim Ademi, ish deputetin e Shqipërisë, z. Azgan Haklajn dhe deputetin e Parlamentit të Kosovës Berat Luzha shpalosën përmendoren e alfabetit.

Pas kësaj të gjithë mysafirët bënë homazh dhe vendosën lule të freskëta në Pllakën përkujtimore kushtuar Kongresit të Dibrës të ngritur para Qendrës për kulturë në vitin 2004, me rastin e shënimit të 95 vjetorit të këtij Kongresi.

Në këtë kuadër u hap edhe ekspozita me piktura e piktorit dibran Sabit Bocku.

Para fillimit të akademisë solemne Inxh. Faruk Kaba, nëpërmjet videoprojektorit shpjegoi trasenë e Rrugës së Arbërit, ndërtimi i së cilës do të jetë edhe një arterie që do të lidh trojet shqiptare dhe fqinjët dhe do t'i japë hov zhvillimit të gjithmbarshëm.

Në sallën e madhe të mbushur përplot me mysafirë nga Shqipëria, Kosova e Maqedonia dhe diaspora, akademinë solemne e hapën kryetarët e dy dibrave.

Argëtim Fida, kryetari i Dibrës së Madhe me këtë rast deklaroi se: "Jemi mbledhur këtu pas 100 viteve të manifestojmë dhe kujtojmë guximin dhe atdhedashurinë e atyre burrave të kombit nga pesë vilajetet të mbledhur në Dibër për të ndërtuar ardhmërinë e kombit tonë dhe për të hedhur poshtë të gjitha tentativat e atyre që deshën ta rrënojnë atë që ishte arritur dhe të ndërpresin vazhdën e angazhimit patriotik për të ndërtuar konturat e para të shtetit të ri shqiptar që do të shpallej në 1912 në Vlorë. Kur të gjithë dëshironin të gllabëronin tokat shqiptare Kongresi i Dibrës tregoi se as xhonturqit dhe as të tjerët nuk mundën ta mposhtin idenë e ndërtuar për shtetin, kombin, gjuhën dhe alfabetin që tani kanë mbetur realitet. Sot këtu jemi bashkë nga të gjitha trojet etnike dhe kështu bashkë duhet të hapërojmë me unitet shpirtëror, gjuhësor e kulturor, por edhe për një zhvillim ekonomik të përbashkët në një evropë të bashkuar, ku kufijtë aadministrativë do të jenë vetëm vija në hartat gjeografike. Hapja e përbashkët me z. Ilir Krosi, simbolizon bashkimin tonë të përjetshëm sot e tutje, idenë e trasuar para 100 viteve të vazhdojmë të bëjmë realitet atë pjesë të pabërë deritani"

Ilir Krosi, kryetar i bashkisë së Peshkopisë, me këtë rast, u shpreh se: "Kjo është një datë e shënuar për Dibrën dhe çështjen shqiptare në përgjithësi. Akoma na presin punë të tjera për të bërë. Përulemi me respekt para atyre burrave që e ngritën Dibrën në këto nivele që është sot, që çështjen kombëtare e ngritën në nivele shumë të larta dhe nuk lejuan që të nëpërkëmbej nga fuqitë e kohës. Në si kryetarë komunash, bashkishë, ministra e deputetë të zgjedhur nga populli, kemi për obligim ta vazhdojmë këtë rrugë që kërkon Dibra, çështja shqiptare, për ta bashkuar Dibrën dhe tërë trojet shqiptare".

Abdilaqim Ademi, zv/kryeministër i Maqedonisë, në fjalën e tij përshëndetëse, tha se: "Ditë e shënuar në kalendarin e së kaluarës sonë është edhe Kongresi i Dibrës nga i cili na ndan plotë një shekull i mbushur me përplot beteja, me shumë orvatjeje që të ruajmë atë më të vlefshmen që kemi – gjuhën dhe kulturën tonë. Ky Kongres u mbajt në Dibër, në qytetin që mund të quhet edhe kërthiza e arsimimit dhe ruajtjes së vlerave shqiptare në këtë pjesë të shqiptarisë dhe më gjerë. Në këtë qytet, i cili si gjatë Perandorisë Osmane, ashtu edhe pas rënies së saj dhe shumë sunduesve tjerë, ishte dhe do mbetet vatër ku gjuha dhe vlerat kombëtare do kultivohen e do mbrohen sa vetë qenia e dibranëve, njësoj sa edhe vatrat e tyre familjare. Atdhetarët që morën pjesë në Kongresin e Dibrës bënë të mundshmen për atë kohë dhe mund të themi me mburrje se ky popull ka qenë i pushtuar, por kurrë nuk ka lejuar që dikush t'ia robërojë atdheun më të shenjtë që ka pasur – gjuhën dhe kulturën e vet. Dhe ndoshta mbrojta e këtyre vlerave ka mundësuar që populli ynë t'i mbijetojë shtrëngatat e panumërta që kanë përfshirë këto hapësira. Kongresi i Dibrës solli edhe vendime të cilat ishin në interes të popullit shqiptarë, që patën ndikim në mbrojtjen dhe kultivimin e gjuhës shqipe. Patriotët që morën pjesë në Kongresin e Dibrës bënë çmos të afirmojnë kërkesat e tyre për modernizimin e arsimimit dhe hapjen e shkollave në viset e banuara me shqiptarët. Në këtë Kongres, për të mbrojtur indin e tyre kombëtarë, patriotët shqiptarë sollën vendime të rëndësishme ndër të cilët edhe atë për ndarjen e shkollave shqipe të shqiptarëve ortodoks nga kisha greke dhe emërimi i priftërinjve shqiptarë në mjediset ortodokse shqiptare, me çka ua bënë me dije të gjithëve se shqiptarët e kishin të qartë si të sforcojnë boshtin etnik kurrizorë, i cili do qëndronte vetëm mbi ndjenjat patriotike kombëtare dhe në ruajtjen e vlerave të përbashkëta.

Ajo që Dibrën e sotme e bënë të ngjashme me atë të vitit të Kongresit është se ajo mbeti vatra e arsimimit shqiptarë, se ky qytet i dha mësuesit e parë të cilët qysh në vitet pasluftës së Dytë Botërore u shpërndan nëpër trevat e Maqedonisë ku jetonin shqiptarët që të arsimonin gjeneratat e reja të popullit të vet. Ajo që dibranët e sotëm i bënë të ngjashëm me ata të vitit kur u mbajt Kongresi i Dibrës është bindja e tyre se gjuha dhe kultura shqiptare duhet ruajtur me po të njëjtin përkushtim si edhe themelet e vatrave familjare. Kongresi i Dibrës është i pari ku mund të thuhet se u arrit zyrtarizimi i gjuhës shqipe në perandorin Osmane. Dibra është një nga vatrat e shqiptarëve të arsimuar, një nga trojet ku shumë më herët se në viset tjera shqiptare në Maqedoni arsimimit i është kushtuar rëndësi e veçantë. Kur rikujtojmë Kongresin e Dibrës ne duhet njëkohësisht të ndërmendin edhe gjithë atë që dha Dibra për shqiptarinë, sa i përket zyrtarizimit të gjuhës shqipe në Maqedoni, ne duhet të punojmë edhe më tej që të realizojmë synimin tonë të dëshiruar. Njësoj siç duhet të bëjmë çmos që Dibra e Kongresit dhe Dibra ku shqiptarët kanë fituar shumë beteja kolektive, të ringjallet, të ndërpritet migracioni dhe ky qytet të mbetet mburrja e shqiptarëve, të jetë atë që ka qenë gjithmonë: prijësi në betejat kulturore të shqiptarëve të Maqedonisë. Duhet të pranojmë hapur se Dibrës ia kemi borxh ta bëjmë qytet ku dibranët do lindin e do plaken duke mos mbajtur kokën nga Amerika dhe shtet perëndimore. Ne pra ia kemi borxh Dibrës ta bëjmë qytet ku e kaluara e lavdishme do jetë themel mbi të cilën do qëndrojë e ardhmja e ndritshme e dibranëve të rinj. Sepse nëse lejojmë që Dibra edhe më tej të zbrazet e të mbetet qytet ku të rinjtë nuk shohin ardhmërinë e vet, neve do na mallkojnë atdhetarët e dikurshëm që bënë shumë që sot edhe ne këtu të flasim shqip e të shkollohemi në gjuhën amtare".

Doc. Dr. Agron Reka, ushtrues i detyrës së rektorit të USHT, së, tha se: "Ajo që është simbolike për këtë datë është se në këtë kuvend ishte kërkesa e atdhetarëve që të themelohen shkolla shqipe në tërë Shqipërinë.

Në vitin 1994 Vendimet e kuvendeve të Dibrës, Tetovës dhe Gostivarit themeluan Univesitetin e Tetovës, pastaj në vitin 2004 u bë zyrtarizimi i Universitetit Shtetëror të Tetovës. Këto dy data do të mbesin të rëndësishme për shqiptarët në Maqedoni. Sakrificë ishte edhe themelimi i USHT-së, që pati shumë armiq të jashtëm, por për fat të keq edhe të brendshëm. Sot gjërat po ndryshojnë. Jam në shërbim të studentëve dhe të diturisë. Jam këtu për drejtësi që të ndërpritet thithja e pamëshirshme e gjakut të këtij institucioni. Jam këtu për një univesitet që në mënyrë të barabartë të kyçet në hapësirën evropiane të arsimit të lartë. Është koha e ndryshimeve, e punës, e drejtësisë dhe e respektit".

Prof. Dr. Arjan Kadiu, në emër të Shoqatës "Bashkësia Dibrane"-Tiranë", u shpreh se: "Ky është një 100-vjetor që nuk përsëritet. Është një ngjarje që historia nuk e ka thënë siç duhet fjalën e vet, sepse shumë dukuri dhe aspekte mund të zbulohen dhe të rilexohen, duke u dhënë vendin e merituar. Dihet se kundërshtarët e vendimeve që u morrën aty u detyruan ta lëshojnë sallën, sepse bashkimi i të gjithë dibranëve ishte

(Vijon në faqen 4)

Adivije Sharofi, bija e Haki Sharofit me një paraqitje emocionale, foli për vuajtjet e babait të saj, internimin e saj familjar nga regjimi komunist, që nuk e la ta shikon babanë para se të vdiste, si edhe për fëmijët e saj të ushqyer me frymën atdhetare e kombëtare.

Kongresi i Dibrës, ditë historike për mbarë kombin shqiptar

(Vijon nga faqja 3)

unik dhe kjo bëri që edhe kongresi të merrte vendime unike. Pesë ishin ato nenet paraprake bashkimore, por ishin edhe 12 nene tjera që iu shtuan atyre pesë neneve. Kjo bëri që të fitonte e të mbizotëronte ideja e çështjes kombëtare, e gjuhës dhe shkollës shqipe. Në gjysmën e parë të shekullit të 19 nuk kishte ngjarje që kishte rëndësi jetike për vendin tonë që të mos merreshte mendimi i dibranëve, sepse Dibra ishte dhe mbeti djep i shqiptarizmës, besnikërisë, i besës, i trimërisë, me një vision shumë të qartë për të ardhmen e vendit. Një historian shkruan se ishte e para herë që në Dibër vinin njerëz nga pesë vilajetet e vendit dhe të gjitha ato qëllime u bënë të hapura. Dibra shpalosi idetë e saj për gjuhën dhe për shkollën shqipe".

Prof. Dr. Nuri Abdiu, kryetar i Shoqatës së Intelektualëve Dibranë në Tiranë, theksoi se: "Dibranët gjatë përpjekjeve të parreshtura, luftërave heroike për të mbijetuar, për ruajtjen e identitetit etnik, kombëtar krijuan kulturën dhe traditën e vet. Burrat e ditur të Dibrës duke mësuar nga përvoja e mendimi shkencor i vendit të tyre dhe i vendeve tjera, kanë dhënë kontributin e tyre edhe në zhvillimin e kulturës dhe dijes kombëtare e më gjerë. Dibra e Nëntë Maleve, Shtatë Teqeve dhe Katër Oxhaqeve përbën mrekulli të natyrës dhe kështjellë të historisë, që u shpalos si një nga trevat e nxehta të atdhedashurisë, kulturës kombëtare, zhvillimeve progresive në shekuj, në ditët tona e në vijim. Dibranët i kanë pasur dhe i kanë në traditën e tyre tubimet, kuvendet, besëlidhjet e kongreset. Kjo është ditë e shënuar me rëndësi historike jo vetëm për Dibrën për për mbarë kombin shqiptar. Dibrës edhe në ditët e sotme i këndohen këngë që mbajnë erë baroti, që ruajnë gjurmë gjaku, që dibranët asnjëherë nuk e kursyen për në luftërat e tyre për liri e pavarësi. Në emër të Shoqaytës LID përulem me respekt të veçantë në kujtim të emrave të të gjithë delegatëve të këtij Kongresi që e treguan veten shqiptarë të vërtetë përballë reaksionit xhonturk dhe përkrahësve të tyre".

Prof. Dr. Mentor Disha, duke përshëndetur në emër të intelektualëve dibranë të Univesitetit të Prishtinës, u shpreh se: "Titullarë të nderuar, zonja e zotërinj, mysafirë të nderuar, bashkëqytetarë të mij të dashur, ju përshëndes të gjithëve, veçmas ju bashkëqytetarë të dashur, falenderojmë Këshillin organizativ për ftesën, duke Ju dëshiruar punë të mbarë dhe suksese".

Ibrahim Kolari, kryetar i Shoqatës Atdhetare Dibrane në SHBA, si përfaqësues i diasporës dibrane, u deklaroi se: "Kjo është ditë historike, gëzuar 100 vjetorin e Kongresit të Dibrës. Ju sjell përshëndetjet më të sinqerta e vëllazërore në emër të Shoqatës Atdhetare Dibrane nga SHBA për këtë 100 vjetor në emër të atyre që janë të pranishëm këtu, por edhe të atyre që nuk patën rastin të jenë

Prof. Dr. Mahmud Hysa: Në Kongresin e Dibrës më 23 korrik 1909 u mblodhën mbi 320 burra dhe Dibra plot gjashtë ditë, i mbajti, i mbrojti dhe i përcolli me tradita bujare, fisnike e mikpritëse. Në këtë Kongres xhonturqit i bënë hesapet pa hanxhinë pse menduan se Dibrën e kanë si në kafez. U doli krejtësisht e kundërta pse kuvendarët patriotë aprovuan edhe 12 pika tjera jashtë dëshirës së xhonturqve. Ky ishte shkaku që Stambolli urdhëroi ndërprerjen e Kongresit, por doli në skenë paria e Dibrës dhe e fshatrave që u çuan në këmbë, rrethuan shtëpinë e Kongresit, i siguruan delegatët dhe mundësuan që Kongresi t'i përfundojë punimet ashtu si ishte interesi i shqiptarëve patriotë.

sonte me ne. U dëshirojmë mbarëvajtje e sukses për këtë manifestim që për kombin tonë ka vlera tejet të çmuara në historinë tonë kombëtare. Shoqata jonë, diaspora në tërësi, prore me mëndje e zemër dëshmon e tregon se angazhimi ynë për mbarëvajtjen kombëtare nuk ka munguar dhe nuk do të mungojë edhe në të ardhmen. Roli ynë jasht trojeve etnike ka qenë në shërbim të afirmimit të vlerave kombëtare, por njëherit edhe duke bërë zbutjen e papunësisë që e ka kapluar këtë nënqiell që të krijojmë kushte më të mira për jetë më të begatshme, pa shpërngulje, gjithmonë në bashkëpunim me pushtetin vendor dhe atë qëndror. SHBA-të u dëshmuan si miq të besueshëm për ne shqiptarët dhe besoj e shpresoj se koha punon për ne dhe ne punojmë për te. Le të mbetet ky 100 vjetor krenari e jona, duke bërë bashkimin tonë shpirtëror e më pastaj t'i përmirësojmë të gjitha zhgënjimet tona nëpër shtigjet e historisë".

Prof. Dr. Mahmud Hysa, në referatin kushtuar 100-vjetorit të Kongresit të Dibrës, theksoi se: "Viti 2009 është një vit trefish jubilar. Për 23 korrikun për çka jemi mbledhur sot këtu, për 2 shtatorin Kongresin e Elbasanit dhe për 1 dhjetorin, Shkollën e parë Normale të hapur në Elbasan. Me kënaqësi historian a ka caktuar të jemi të parët.

Në Kongresin e Dibrës më 23 korrik 1909 u mblodhën mbi 320 burra dhe Dibra plot gjashtë ditë, i mbajti, i mbrojti dhe i përcolli me tradita bujare, fisnike e mikpritëse. Në këtë Kongres xhonturqit i bënë hesapet pa hanxhinë pse menduan se Dibrën e kanë si në kafez. U doli krejtësisht e kundërta pse kuvendarët patriotë aprovuan edhe 12 pika tjera jashtë dëshirës së xhonturqve. Ky ishte shkaku që Stambolli urdhëroi ndërprerjen e Kongresit, por doli në skenë paria e Dibrës dhe e fshatrave që u çuan në këmbë, rrethuan shtëpinë e Kongresit, i siguruan delegatët dhe mundësuan që Kongresi t'i përfundojë punimet ashtu si ishte interesi i shqiptarëve patriotë. Në ditën e sotme para 100 viteve gjeti terren të përshtashëm diplomacia e Haxhi Vehbi Dibrës, që Kongresi t'i zhvillojë punimet siç ishte më së miri për çështjen shqiptare. U pranuan dhe fuqizuan kërkesat imediate të shqiptarëve për shtetin e parë të ardhshëm shqiptar. Dhe s'ka pse të mos krenohet sot Dibra me vendimet që u sollën në këtë Kongres, me triuffin e forcave patriotike dhe debaklin e atyre proqeveritare xhonturke. Aty morën pjesë patriotët më të dalluar të kohës nga të gjitha trojet e klubet shqiptare dhe jashta trojeve shqiptare si nga Stambolli, Kajro, Aleksandria, Selaniku, Follorina, Kosturi, Sofja, Velesi. Gjatë punimeve të Kongresit u përdor gjuha shqipe, u morën vendime për hapjen e shkollave shqipe, vendime ekonomike, juridike, fiskale, që shërbimi ushtarak të kryhet në trojet shqiptare, të hapen hekurudha, nëpunësit shterorë ta njohin gjuhën shqipe, kërkesa që de fakto ishin premise të shtetësisë.

Nuk mund ta kuptojmë qëndrimin përçmues që ka historiografia shqiptare për Kongresin e Dbrës, që ose nuk e llogarisin fare si Kongres kombëtar, ose e vlerësojnë në mënyrë tejet subjektiviste, që i shtrembërojnë rezultatet e këtij Kongresi. Është koha e fundit që në revidohen qëndrimet aprioristike të gjertanishme të historianëve dhe të historiografisë shqiptare dhe të vendoset Kongresi i Dibrës në binarët që i meriton objektivisht dhe realisht, si Kongres ku u shpreh niveli i lartë i ndërgjegjes kombëtare, Kongres i vendimeve të rëndësishme për të ardhmen e kombit shqiptar, ku u kërkua dhe sollën vendime për shtetin e parë shqiptar që u arrit në vitin 1912".

Pas kësaj u lexua telegram urimi dërguar nga Teqeja e Madhe Autoqevale Ballkanike me seli në Gjakovë e Prizren nga postmbajtësi Sheh Musa Shehu, ku ndër të tjera thuhej se: "Kongresi i Dibrës ishte një ngjarje me peshë në drejtimin e mëtejmë të lëvizjeve dhe përpjekjeve tona për çlirim, unitet, dinjitet dhe pavarësi kombëtare. Në mesazhin për politikën aktuale shqiptare në Tiranë, Shkup, Tetovë, Prishtinë, Ulqin, dhe bashkëkombasit tanë në Prevezë e Janinë, shton se, në disa pjesë të hartës së atdheut, liderët tanë politike duhet vënë gishtin në kokë, për gjuhën që përdorin ndaj njëri-tjetrit, për punën që për ditë e bëjnë. Duhet rënë në ujdi se përçarja, urrejtja mes tyre dhe lufta pakompromis e tyre që po bëjnë, çojnë ujin vetëm në mulli të huaj. Duhet të kemi unitet, sepse kemi shumë armiq rreth vetes", u tha në fund të telegramit.

Në programin artistik të kësaj akademie solemne, Kastriot Tusha këndoi Himnin e djelmërisë, shkruar nga Haki Sharofi dhe këngë tjera, ndërsa fragmente nga Lahuta e Malsisë recituan Burhan Skikuli, Vlona Vojka dhe Esat Ushtelenca.



Të premten, më datë 24 korrik 2009, në ditën e dytë të shënimit të 100-Vjetorit të Kongresit të Dibrës, u mbajt konferenca shkencore në të cilën studjuesit e historisë paraqitën temat e tyre.

"DERVISH HIMA NË KONGRESIN E DIBRËS"

Dr. Nebi Dervishi, me temën e "**Dervish Hima në Kongresin e Dibrës**", hodhi më shumë dritë mbi Dervish Himën, "si tribun i shquar i Rilindjes Kombëtare Shqiptare, intelektual i madh i kohës, patriot i flaktë, veprimtar i palodhur, luftëtar i paepur për çështjen kombëtare, shkollën shqipe, i cili tërë jetën dhe pasurinë e tij ia dedikoi luftës për liri, pavarësi dhe të drejta kombëtare, duke lënë pas një trashigimi politike e kulturore nga më të rrallat e kohës. Konsulli austrohungarez në Manastir, njoftonte Vjenën se "Dervish Hima, ky organizator i jashtëzakonshëm, i zgjuar dhe konspirator profesionist, po i organizon mjaft mirë komitetet e fshehta shqiptare". Shkrimet briliante të Dervish Himës përfaqësojnë majat e publicistikës shqiptare. Kërkoi që edhe shqiptarëve tu njihen të drejtat që u janë njohur kombeve tjera. Dervish Hima sëbashku me patriotët jerë në Kongresin e Dibrës, kundërshtuan programin xhonturk".

"GJUHA SHQIPE DHE ALFABETI I GJUHËS SHQIPE NË KONGRESIN E DIBRËS"

Prof. Dr. Mahmud Hysa, me temën **"Gjuha shqipe dhe alfabeti i gjuhës shqipe në Kongresin e Dibrës"**, theksoi se: "Kongresi i Dibrës është dëshmia më e gjallë se politikën xhonturke e karakterizonte hipokrizia politike si në kohën e Turqisë monarkiste, duke e kufizuar e bërë të pamundur që qytetarët dhe institucionet shtetërore ta përdorin gjuhën shqipe në mjediset e një entiteti. Xhonturqit që organizuan Kongresin e Dibrës me qëllime destruktive për shqiptarët, duke dashur t'i detyrojnë edhe me ligj të tregohen qytetarë lojalë dhe përkrahës të pushtetit të ri, nuk parashihnin përdorimin e gjuhës shqipe në asnjërin nen nga katër-pesë pikat e propozuara të tyre, por përdorimin e gjuhës shqipe në këtë Kongres e kishin kufizuar, pamundësuar, abstrakuar në të gjitha fushat e përdorimit dhe të komunikimit. Në të gjitha këto segmente të disfavorshme për çështjen shqiptare në përgjithësi dhe dhe për pozitën e gjuhës shqipe ne veçanti, Kongresi arriti rezultate të kundërta me politikën xhonturke. Gjuha shqipe u bë objekt në Kongres duke folur në gjuhën shqipe dhe duke kërkuar hapjen e shkollave shqipe dhe përdorimin e gjuhës shqipe"

Historia e përdorimit të alfabetit për shkrimin e gjuhës shqipe është më e gjatë se ajo e shkrimit të gjuhës shqipe, një histori plot trazira e konflikte që vazhdoi deri në Kongresin e Dytë të Manastirit në vitin 1910. Gjuha shqipe dhe alfabeti i gjuhës shqipe janë dy segmente të rëndësishme të vetë dijes kombëtare që rilindasit arritën t'i diferencojnë".

"DIPLOMATËT A-H PËR KONGRESIN E DIBRËS"

Dr. Marenglen Verli, me temën "**Diplomatët A-H për Kongresin e Dibrës**", paraqiti, "një studim shkencor për veprimtarinë e konsujve të huaj para dhe pas Kongresit të Dibrës. Ai shpjegoi jehonën që bënin kuvendet e shqiptarëve te të huajt, duke kërkuar e sensibilizuar të drejtat e tyre, përkundër territ informativ, pengesave, presioneve të ndryshme që bente Perandoria Osmane ndaj patriotëve dhe çështjes shqiptare. Ai theksoi se nuk ishte e rastit që ky Kongres u mbajt në Dibër, sepse Dibra kishte potencialin e nevojshëm organizativ, vizionar dhe financiar për një Kongres të tillë".

Dr. Muhamed Mala, me temën "Rrethanat politike e fetare në Shqipëri në kohën e mbajtjes së Kongresit të Dibrës", foli se, "Rrethanat në të cilat zhvillohej veprimtaria patriotike e shqiptarëve në dekadën e parë të shekullit XX nuk ishin aspak të favorshme për shqiptarët. Në trevat shqiptare ndërlidheshin interesat politike të shumë shteteve të ndikuara edhe nga përkatësia multifetare e shqiptarëve. Përkatësinë muslimane të shumicës shqiptare xhonturqit kurdoherë e shikonin si favor të tyre, ndërsa shtetet si Austria e Italia llogarisnin interesat e veta përmes pjesëtarëve të konfesionit katolik, kurse elementi dhe intersi grek mundohej të depërtonte përmes orthodoksisë së shqiptarëve. Në këto rrethana agjenda e aktivitetit patriotik shqiptar nënkuptonte paralelisht zhvillimin e luftës politike me atë kulturore për emancipimin dhe arsimimin e brezave, avancimin politik dhe ruajtjen e tolerancës fetare. Klerikët reaksionarë elementet fanatike turkofile zhvilluan një propagandë kundër arsimit shqip dhe tani ju duhej një zyrtarizim të cilin mëtonin ta bëjnë me Kongresin e Dibrës. Rëndësia e kongresit të Dibrës konsiston në faktin se la të kuptohet mospajtimi i shqiptarëve me gjendjen e tyre të mjeruar dhe përpjekjet për ngritje dhe qytetrim".

"Konferenca shkencore ndërkombëtare për 100-Vjetorin e Kongresit të Dibrës, ishte tepër e suksesshme, esenciale shkencore me materiale edhe eseistike, që në disa pika ndiçuan vlerat e këtij Kongresi që mbetet nyje statike e historisë kombëtare shqiptare".

KONFERENCA SHKENCORE PËR 100-VJETORIN E KONGRESIT TË DIBRËS

Më shumë dritë për këtë datë mbarëkombëtare

"SHTYPI SHQIPTAR NË MËRGIM MBI KONGRESIN E DIBRËS"

Dr. Muzafer Bislimi, me temën **"Shtypi patriotik shqiptar në mërgim mbi Kongresin e Dibrës dhe roli i tij në demaskimin e politikës xhonturke ndaj shqiptarëve",** theksoi se, "Shtypi patriotik shqiptar në mërgim, posaçërisht ai në SHBA dhe Egjipt, theksonin se xhonturqit nuk do t'i plotësojnë kërkesat e shqiptarëve. Shumica e artikujve ishin me pseudonime ose pa emër autori për shkaqe të njohura. Gazeta të tilla ishin "Kombi" dhe Dielli" në SHBA, "Drita" në Sofje", "Shkopi" dhe "Rufeja" në Kajro etj. Në në shkrim në "Shkopi" të datës 15 nëntor 1908, autori pyet veten "pse ne shqiptaërt nuk mësuam asgjë nga historia. Ne e shpëtuam Greqinë, që ajo pastaj nëpërmjet "fanariotëve" të na e kontestojë gjuhën dhe kombin, poashtu u sakrifikuam për Turqinë, të cilën e shpëtuam prej shkatërrimit". Pse xhonturqit nuk e realizuan revolucionin në Anadolli? Kongresi i Dibrës si një vazhdimësi e politikës dyfëtyrëshe xhonturke ndaj shqiptarëve, bëri që të mos kalojnë pikat e parapara të xhonturqve, por ato të modifikohen dhe futen edhe pika tjera me karakter kombëtar shqiptar. Historiografia shqiptare duhet tu kushtojë më shumë kujdes këtyre ngjarjeve dhe burimeve osmane që për atë kohë janë zyrtare, sepse deri sot më shumë janë përdorur, dokumente të konzujve të huaj, korrespondentë të klubeve, shkrime të gazetave etj. "

"KONTRIBUTI I QENAN MANASTIRLIUT NË KONGRESIN E DIBRËS"

Mr. Ruzhdi Lata, me temën **"Kontributi i Qenan Manastirliut në Kongresin e Dibrës",** shtoi se, "Veprës së Qenan Manastirliut i ka bërë një studim të veçantë Haki Sharofi, por këtij libri i referohen gati tërë historiografët që janë marë me këtë ngjarje historike. Megjithatë për kontributin që ka dhënë ky personalitet në ecurinë e rrjedhave, të Kongresit, në ballafaqimet, dialogjet, përplasjet, konfrontimet dhe në solucionet e zgjidhjes së disa nyjeve, në qëndrimet parimore e të drejta, në përmbajtjen që u ka dhënë temave më të "nxehta" në Kongres, mendoj se nuk është folur aqë sa e ka merituar ky delegat. Vetëm përmes analizës së qëndrimeve, diskutimeve, rezonimeve, e propozimeve që ka shfaqur ky delegat në këtë Kongres do ta kuptojmë më së miri atmosferën që ka mbizotëruar në këtë Kongres. Qenan Manastirliu, ka qenë shumë aktiv, pozitiv dhe pragmatik, pse ka mbajtur gjithmonë anën e delegatëve kombëtarë, jo vetëm duke ngritur gishtin, por edhe me diskutimet e tij të llogjikshme, parimore e kritike që kanë rezultuar në anën kombëtare, përkundrejt shumë rasteve të disa delegatëve me zë që kanë ndenjur indiferentë. Për Qenan Manastirliun si delegat, diskutant dhe kronist, shumë pak dijmë për biografinë e tij personale e politike. E dijmë që është nga Manastiri, por nuk e dijmë përkatësinë e tij etnike, moshën, formimin intelektual, motivet e përcaktimeve të tij politike dhe finalen e jetës së tij. Ai me ligjeratat e diskutimet në Kongres e provon veten se është një shqiptar fisnik dhe patriot i flaktë. Elida Jorgoni kur paraqet emrat e pjesëmarrësve në këtë Kongres thotë se "Qenan bej Zija Manastiri-kronist dhe delegate i komunitetit turk të Manastirit ". Të jetë turk si shqiptarofil, kjo nuk na befason, por të jetë edhe një veprimtar i Lëvizjes Kombëtare siç thotë Sharofi, kjo është befasuese, pse ashtu si flet pë favor të çështjes shqiptare, për çështjen e gjuhës, të shkollave, të kërkesave legjitime për shtetin e ardhshëm shqiptar, këtë mund ta bëjë vetëm një veprimtar dhe ideolog i çështjes kombëtare, një përfaqësues i këtij entiteti".

"QËNDRIMET DHE VLERËSIMET RRETH KRYETARIT TË KONGRESIT TË DIBRËS, ISMAIL PASHË SARAÇI"

Dr. Mois Kamberi, me temën **"Qëndrimet dhe vlerësimet rreth kryetarit të Kongresit të Dibrës, Ismail Pashë Saraçi"**, u shpreh se, "Shumë punime e botime jo vetëm nuk e përmendin Ismail Pashë Saraçin si kryetarin e parë të Kongresit të Dibrës, por e konsiderojnë si bashkëpunëtor të besuar të xhonturqve dhe Dibrën si mbështetëse të sigurtë të politikave xhonturke. Bashkëkohasitdhe kujtimshkruesit Qenan Manastirliu, Dervish Hima, Ismail Strezimiri, Haki Stërmilli etj., e vlerësojnë si organizator, kontribues dhe financues të disa klubeve shqiptare, deputet të Dibrës në parlamentin turk, delegat, organizues, financues të Kongresit të Dibrës dhe kryetar të këtij Kongresi, financues për hapjen e shkollave shqipe në Dibër dhe në krahina të tjera shqiptare, atdhetar që luftoi gjatë tërë jetës në shërbim të çështjes kombëtare. Ai vdiq gjatë hapjes se Kongresit dhe për këtë ka dy versione. I pari se vdiq nga infrakti dhe i dyti lidhet me helmimin nga kundërshtarët politikë. I gjithë populli i Dibrës mori pjesë në funeralin madhështor të tij. Pas vdekjes së Ismail Pashë Saraçit, kryetar i kongresit u zgjodh Haxhi Vehbi Dibra".

"POLITIKA E XHONTURQVE DHE ÇËSHTJA KOMBËTARE SHQIPTARE NË KONGRESIN E DIBRËS"

Dr. Fahredin Shabani dhe **Mr. sc. Muhamet Qerimi**, me temën **"Politika e xhonturqve dhe çështja kombëtare shqiptare në Kongresin e Dibrës",** nënvizuan se: "Me këtë copëtim të territoreve dhe të popullit tonë në 3-4 shtete, rreth një shekull me regjime dhe ideologji të ndryshme në këto shtete janë ndryshuar dhe përshtatur ngjarjet e rëndësishme historike sipas tekeve apo diktatorëve të regjimeve të ndryshme. Në kohën kur Xhavit Pasha me ekspeditën e tij në Kosovë po haste në vështirësi të shumta, elita xhonturke mendoi se me mjete paqesore duke thirrur Kongresin e Dibrës t'i qetësonte shqiptarët në njëvjetorin e shpalljes së Kushtetutës. Komiteti xhonturk "Bashkim dhe Përparim" në Kongresin e vet në Selanik në maj të vitit 1909, propozoi që të gjitha shkollat fillore të mbesin si kanë qenë, të gjitha gjimnazet ku mësimi nuk zhvillohet në gjuhën osmane të mbyllen, nxënësit të kalojnë në shkollat ku mësimi zhvillohet në gjuhën osmane. Në Kongresin e Dibrës platforma e Kongresit e parapërgatitur nga organizatorët xhonturq u hodh poshtë. "

"KONGRESI I DIBRËS NË RRAFSH HISTORIOGRAFIK"

Prof. Dr. Gazmend Shpuza, me temën **"Kongresi i Dibrës në rrafsh historiografik"**, theksoi se, "Xhonturqve nuk u shkoi për dore që këtij manifestimi politik t'i japin ngjyresë thjesht xhonturke. Kalendari "Afërdita" pavarësisht nga pakënaqësia ndaj rezultateve të tyre, Kongresin e Dibrës e ven në një rafsh me atë të Manastirit për sa i takonte peshës dhe rëndësisë së vendimeve të tyre. Vendimet atdhetare dhe përparimtare, si hapja e shkollave fillore dhe të mesme në të cilat mësimi do të zhvillohej në gjuhën shqipe, shkëputja e shkollave nga kisha dhe zhvillimi i shërbesave fetare në gjuhën amtare, njohja e dokeve dhe e gjuhës shqipe, vendosja e rregullit në sistemin e thirrjeve në ushtri, modernizimi i medreseve etj, shënonin parashtrimin publik në shkallë perandorie të programit autonomist të Lëvizjes sonë Kombëtare. Në vendimet e Dibrës për çështjen e alfabetit shprehimisht nuk shtrohej asgjë më pak se detyra për zbatimin e vendimit të Kongresit të Manastirit. Në kundërshtim me realitetin historik vihet shenja e barazimit midis vendimeve të Kongresit dhe reaksionit të egër që shpërtheu më pas kundër vendimeve të tij. Vënia e alfabetit latin për gjuhën shqipe në rend të ditës në kongresin e Dibrës, ushtroi një ndikim shumë të gjerë jashtë trevave shqiptare, në shkallë perandorake. Intelektualët iluministë turq, duke i bërë jehonë luftës së shqiptarëve për alfabetin latin të gjuhës së tyre shprehën domosdoshmërinë që edhe vetë turqit të ecnin në të njëjtën rrugë".

"ÇËSHTJA E ARSIMIT DHE SHKOLLAVE SHQIPE NË KONGRESIN E DIBRËS"

Mr. Rrezehana Hysa, me temën **"Çështja e arsimit dhe shkollave shqipe në Kongresin e Dibrës"**, spjegoi se, "Marrja pjesë e shumë deputetëve shqiptarë ishte strategji e klubeve shqiptare, qëllimi i të cilëve ishte që sa më shumë që të jetë e mundur të sprovohet çështja kombëtare. Me qëllim të krijimit të një atmosfere të këndshme në favor të Perandorisë para fillimit të Kongresit, turqit amnestuan shumë krerë të Lëvizjes shqipëtare dhe kumtuan përdorimin e gjuhës zyrtare në shkollat fillore dhe në mjediset shqiptare. Valiu i Manastirit para mbajtjes së Kongresit nuk e fshehu përkrahjen e tij për hapjen e një shkolle Normale me konvikt në Dibër dhe Elbasan me 700 nxënës. Abdyl bej Ypi, Hafiz Ali Korça, e shumë të tjerë me programin e përpiluar në mbledhjet e fshehta në Baba Teqen e Shabanit dhe duke u bazuar në vendimet e Kongresit të Manastirit dhe në aspiratat e rilindasve tanë, synonin riorganizimin dhe modernizimin e arsimit në viset e banuara me shqiptarë, pajisjen e medreseve me programeve të reja nga lëmi i shkencave dhe arteve të ndryshme, hapjen e shkollave shqipe, qytetëse, gjimnaze dhe shkollave teknike bujqësore, ku mësimdhënësit vetë do t'i zgjidhnin metodat e punës edukative, hapjen e një shkolle normale të financuar nga shteti që do të përgadiste mësimdhënës të mirëfilltë dhe pedagog të sprovuar për tërë Shqipërinë dhe tërë shqiptarët".



Një kurorë te varri i Said Najdenit

EPILOG

Dr. Arjan Kadiu, gjatë diskutimit lidhur me temat e paraqitura tha se, " pati disa materiale në formë përshkruese, disa të paargumentuara, pa konkluzione dhe arritje. Sugjeroi që në të ardhmen të angazhohen më shumë të rinj në hulumtimet historike, sepse Dibra ka shumë të rinj shkolluar.

Avni Agolli, bashkëkohanik dhe bashkë i burgosur me Hafiz Ali Korçën evokoi kujtimet e tij për Hafiz Ali Korçën gjatë ditëve të kaluaranë burg, dhe për enthuziazmin e tij patriotik, duke shtuar se shteti nuk bëri asgjë për këtë figurë të shquar kombëtare.

Adivije Sharofi, bija e Haki Sharofit me një paraqitje emocionale, foli për vuajtjet e babait të saj, internimin e saj familjar nga regjimi komunist, që nuk e la ta shikon babanë para se të vdiste, si edhe për fëmijët e saj të ushqyer me frymën atdhetare e kombëtare.

Sazan Papraniku, dha spjegimet e tij lidhur me Dan Camin, Eqrem Camin dhe Fuad Dibrën për çështjen kombëtare dhe Kongresin e Dibrës.

Prof Dr. Mahmud Hysa, në emër të grupit drejtues të kësaj konference shkencore, u shpreh se, Konferenca shkencore ndërkombëtare për 100-Vjetorin e Kongresit të Dibrës, ishte tepër e suksesshme, esenciale shkencore me materiale edhe eseistike, që në disa pika ndiçuan vlerat e këtij Kongresi që mbetet nyje statike e historisë kombëtare shqiptare. Temat e lexuara dhe të atyre që për arsye objektive nuk ishin të pranishëm do të botohen në një libër.

Argëtim Fida, kryetar i komunës së Dibrës, falenderoi të gjithë historianët për kontributin e tyre shkencor në zbardhjen e fakteve lidhur me Kongresin e Dibrës dhe pjesëmarësit për vëmendjen e tyre.

Pas kësaj të gjithë të pranishmit bënë homazh dhe vendosën kurorë mbi varrin e Said Najdenit iluministit Dibran dhe mbarëkombëtar.

Rexhep TORTE

Rruga Arbërit nr. 39

Liria e mendimit për bëmat e Josif Bagerit e shtruar në rafshin kombëtar na bëri që të vizitojmë vendin e kasolles së tij në fshatin Nistrovë.

reportazh



Magjia e imazhit për perlat e Rekës së Epërme

Edhe pas 100 viteve Reka e Bagerit nuk quhet Shqipni!?...

Nga: **Atli DEMA**

S'due ktu uni me vdek,
po n'Shqypni, atje në Rek!

Liria e mendimit për bëmat e Josif Bagerit e shtruar në rafshin kombëtar na bëri që të vizitojmë vendin e kasolles së tij në fshatin Nistrovë.

Në puhizën e fillimit të korikut në verandën „Uraniku" pikërisht në bisedat rreth mbajtjes së 100 vjetorit të kongresit të Dibrës mendja na shkon lart tek Reka-Nistrova e Bagerit, tek shkëmbi dhe kopshti i tij rrethues që dhanë uratën e parë për lindjen e djemve të Shqipnisë pikërisht aty ku dashuria për liri e pavarësi ushqehej që në fëmijëri.

Në bisedat e ndodhive të kohës gjatë udhëtimit tonë me Dulin, Fitimin, Duron dhe Reshatin, flasim për rrugëtimin e vështirë nëpër kohë të mbushura plot tradita e karare shqiptare, që i bëri të mos zhduken tërësisht por të jetojnë në brezat e personalitetit të tyre. Kështu, na kujtoheshin edhe shprehjet e të ndjerit doktor Lutfi Turkeshi, kur thoshte: „sa herë që viziton luginën e Rekës plot nishane midis dy anëve, që i ndan lumi i tujgur i Radikës, vëren se historia e gjakosur e shqiptarëve e thurur nëpër këngë është ndryshe nga ajo kërkimore disi e shkarkuar nga analistët shkencorë".

Folkloristët e rikujtojnë të kaluarën si thurrje kohe në përshtypje dhe si pjesë e rrëfimit të tyre, që është një e vërtetë e mirëfilltë, që ka udhë. „Udha që s'mbaron, sepse vetë jeta është një rrugëtim drejt të panjohurës e ngarkuar me aq barrë, brenga e ankime, por edhe bukuri e dashuri. Poashtu edhe për momentin si më parë shqiptarët shalojnë shpesh mbi vdekjen për liri. Ky rrugëtim nuk ka fund sepse ecim tek fillimi dhe fundi i kësaj udhe që është fillimi i subjektit të Rekës së Epërme-Josif Bageri, ndaj gjatë udhëtimit tonë drejt kasolles nën gurrë, Duli hap letrën e vajtimit të paluar nga dora e Thoma Kacorit. E cila, e ruajtur me kujdes na tërhoqi vëmendjen tek burrëria e Bagerit në poezinë e tij në prozë „Vajtim" që ja ka kushtuar djalit të tij 16 vjeçar Kristo, që vritet në luftën e rreptë me barbarë në Maqedoni.

Në këtë letër ngjyrë fytyre, e që era i kundërmon gjak e barot e shkruar në gazetën Shpnesa e Shqypënis, 27 maj 1907 thuhej: *„Kristo, o bir, zemra ime, qofsh bekuar! Ti nuk rrojte bir në këtë jetë: varrin si trim ti e ke gjetë. Prej Perendisë, o bir qe shkrue: ti me vdek në vend të shenjtënuet: në llogore të kanë mbuluet, ku luftove!*

Ditën që të kanë vra, o bir, un kremtojë: kangë me shumë shokë këndojë, edhe drejtësinë unë kërkojë: nëpër rrugët e Sofjes manifestojë, si punëtor i ngushtuet, prej shumë pune i dobësuet... Ah! m'helmove!

Ditën e kësaj mordjës s'zezë, kur ishje ti shtrirë, prej nji plumbit ngjyet n'gjak! Ah dekë e ambël, dekë me shokë; vdiqe si burrë, jo si grue, lavde e nder në Shqyptarë; kjo m'ngushëlloj e brohoriti, o bir, se kam lind një trim të mirë – dhe m'gëzove.

Deshje me dekë ah ti o bir, për liri, se t'grazitoj ty robënija; gjaku e'vlonte kah trimërija; kape hutën „Maleherë" si djalë i ri more udhën dhe shkove!... e një lek mue mo çove – e m'kujtove. ...

Tri herë në luftë hine, o bir, ti me barbarë; të lumtë dora që hodhe bomba. . . sheshin mbushe me gjak dhomba; ti shumë vrave dhe i plagove halldupët ushtarë – trim i fjamtur si shqyptar; paq mbrojtim, o bir i mbarë – se s'më harrove.

Më thanë shokët; „qenka trim Kristo Bageri". Edhe Komiteti shumë të lëvdoi; ah dhe mue bir m'ngushëllojë; por s'paçë fat, o bir, ah unë i mjeri – për liri kangë unë me ty bashkë të këndojë, e krah për krah bashkë të luftojë; po më naltove.

Shpejt, o bir, dhe unë do t'vi, si ti me gjetë dekën për liri e drejtësi, për me i gëzue në shqypnie; mjaft ma e patmë në robëni Rekën; kjo më ka hije në këtë jetë, si ti, o bir, mbrojtim (pushim) me gjet- atje ku shkove!

Me këtë poezi të dalë nga shpirti i ndritshëm i poetit, heshtja kishte hapur mordjen burrërore të Bagerit, e cila bëri që për një kohë të ecim udhës së Nistrovës në meditim...

Në këto gjelbërime pushuese që qetësia i ngjan magjishmërisë udhës pyes veten:

Okupimi s'ka mbaruar, barbaria s'ka mbaruar edhe pas 100 viteve të Bagerit e Kristos Reka është në robëri, në këto male të thepisura duhet ntrashur vijën me gjak e barot... këto vise akoma nuk quhen sic shpreheshte Bageri për Rekën:

"…Me vdek k'tu uni këtë 'rend,
s'due tëm lini n'këtë vend
korpin k'tu mos ma vorroni,
po në Shqypni të ma çoni...
S'due k'tu uni me vdek,
po n'Shqypni, atje në Rek!..."

Për momentin afrohemi tek një bankinë që gjindet në të djathtë të rrugës, ku aty afër ujin rridhte një çesëm e ndërtuar në shenjë përkujtimi. Heshtja u thye. Fitimi dhe Niku propozuan që pikërisht aty të hamë drekë, por nga freskia dhe ajri i pastër, buka dhe djathi filluan të përçapen dhunshëm nëpër ritminë e dhëmbëve.

Përballë nesh disa shtëpi të rralla sikur bënin pararojë rrëzë majes së Korabit, që shtrihet teposhtë si anfiteatër bagëtish dhe pishnajesh, që dukshëm ishin rralluar nga prerjet pa kriter. Është dhunti kohe kjo që po bëhet në këto fshatra të ruajtura me dashuri që nga i ati i Bagerit, Jovani dhe gjyshi Nikollë Bageri, por, pushtetet okupuese të rradhës, nuk kanë asfaltuar qoftë edhe 1 metër katror rrugë, ashtu si për në Nistrovë e Bibaj rruga ishte e njejtë me baltë edhe në drejtim të fshatit Grekaj, Tanushë e Ribnicë.

Meditimin e radhës e bëmë të ulur në verandën e Bagerit në Nistrovë. Atje tek shkrepi që gjindet disa metra larg temeleve të kasolles së Bagerit. Të ulur mbi shkrepin e madh sodisim ambientin e poetit, ku si sinfoni gumëzhonte përroi i Bukovunit ku poeti thuri vargjet idilike të kohës.

Ju n'luftë fluturoni
Drejtësinë të kërkoni,
Ngrifnju t'gjithë sa jini
Anmikut prita vini
Se kombi me za të thret
Ta shpëtojsh e ta lirojsh-
Drejtësi njeriu t'kërkosh

Veprimtaria patriotike e publicistike e Josif Bagerit dhe vepra letrare e tij u lidh ngushtë me koloninë shqiptare të Sofjes, e cila themeloi shoqërinë "Dëshira" në vitin 1893 dhe u botua pas dy vitesh më 1895. Qëllimi i formimit të shoqërisë "Dëshirë" ishte: "Për të përhapur dituri dhe mësimin e gjuhës shqipe dhe për të hapur mësonjtore në gjuhën shqipe në Shqipëri". Siç vërehej edhe nga programi dhe kushtet për t'u bërë anëtar i saj, shoqëria shquhet për karakterin e saj kulturor e arsimor ashtu si shoqëria e Stambollit, e Bukureshtit etj. Shoqëria e shqiptarëve të Sofjes e filloi mirë veprimtarinë edukative nëpërmjet mbrëmjeve të ndryshme ku lexoheshin libra e gazeta në gjuhën shqipe.

Angazhimi i Bagerit dhe Said Najdenit për hapjen e shkollave shqipe në krahinën e Dibrës e më gjërë okupatorët i thirrnin *Josif turku* dhe *Said kauri*. Ishin këto dy emra të padëshiruer dhe duke ushqyer ndasinë fetarë ata rritnin pushtetet sunduese në këta treva, sepse Saidi si hoxhë dhe njeri i ditur deshin që të punojë për turqit dhe gjuhën e tyre poashtu kleri orthodoks Josifin e quanin Josif Turku.

Bageri në vargjet e tij për ritjen e urejtjes ndërfetare shton:


Gjith kjo Tyrki, vu këtë djallzi
Për mos me mbet, burr në Shqypni.
Një mjegull e madhe mjedis ditës bardh
Një errsi e zezë, mbi ne na kish ardhë…
Nuk na linte djellin, as yll na me pa,
Nuk na linte t'mirën pi t'keqes me da
Njani për fe, tjetri për din
Disa jam Tyrk, thon, dhe elin!
Kta vlla me vlla , gjith një po grinden…
E njëni tjetrit kurri s'I binden
Njëni thot "mir jam në këtë jet"
Tjetri thot: "Unt'mirën kom gjet"
Nji pal thon: "jemi taljan!"
Disa: "Turq, grek e sllavjan!"
Një pal thiren "efendi!"
Disa thiren: "Agallar!
Po mos me pas as ar, as far;
E të tjerët "Qirie!"
Po kta të gjith bij Shqypnie"

Fitimi shton se edhe Jovan Bageri i ati i Josifit, ishte një figurë e pastër që e donte atdheun e vet. Ai i futi në zemër të birit, dashurinë për Shqipërinë. Edhe më vonë, madje edhe kur Josifi vetë ishte bërë baba me një tufë kalamaj dhe ndodhej në Sofje,

(Vijon në faqen 12)



Themelet e shtëpisë së Bagerit



Ka një shtrirje shumë të gjërë dhe kufizohet nga Veriu me Bushtricën, nga Lindja me Bjeshkët e Korabit që zbresin gjer në Gostivar, nga Perendimi me Kalisin dhe nga Jugu ndahet me Ujemujën me lumin e Veleshicës

KALAJA E DODËS

Nga: **NAIM PLAKU**

SHTRIRJA GJEOGRAFIKE

Është quajtur kështu nga një toponim tepër i hershëm, që sot shummëkush nuk i jep "dum", dmth nuk di ta shpjegojë qartë. Megjitatë, nga tregimet që kemi mundur të mbledhim, tregojnë se aty, që para nënëtë shekujsh ka qenë një kala, e cila shërbente për mbrojtjen e gjithë zonës (nahijes) nga ndonjë invazion i mundshëm sllav. Kalaja ka qenë ngritur pikërisht aty ku ishte dhe qafa më e rrezikshme nga mund të hynin ushtritë turke asokohe në vendin tonë Prej shumë vitesh Kalaja e Dodës administravisht i është mbështetur Dibrës. Kjo ka pasur disa arsye. E para ka qenë që, pothuajse të gjitha marrëdhëniet martesore e miqësore bëhëshin midis dy zonave, miqësisht të administrueshme dhe me lidhje të forta familjare: nip-mbesë, nip-dajë, etj. E dyta ishte se kishte zakone të përbashkëta që puqeshin e respektoheshin me rigorozitet nga palët. Këtu mund të sjellim në kujtesë një varg ritesh që janë të njejta edhe sot.Edhe banorëve iu pëlqen ta quajnë vetën dibrnanë, sepse të tillë kan qenë ndër shëkuj të vetëquajtur. Zona, ose krahina etnografike qe kemi mundur të përcaktojmë, kësaj krahine i përkon ajo që ne sot e quajmë, e mund ta emërtojmë, Kalaja e Dodës.

Ka një shtrirje shumë të gjërë dhe kufizohet nga Veriu me Bushtricën, nga Lindja me Bjeshkët e Korabit që zbresin gjer në Gostivar, nga Perendimi me Kalisin dhe nga Jugu ndahet me Ujemujën me lumin e Veleshicës. Fshatrat e kësaj komune janë Radomira me lagjet e përmendura të saj: Tejs, Stërdok, Cernjevë, Cereni, Ploshtani, Vasijet dhe Shullani.

PAK HISTORI

Kalaja e Dodës është banuar që hejrët. Për këtë flasin shumë vendbanime të hershme. Shkencëtari gjerman Johan G. Von Hahn e nisi udhëtimin e tij shekuj më parë për gjetur Kalanë e famshme që, siç e kishte lexuar ai, ndodhej në afërsi të Korabit, mbi një shkëmb të mahnitshëm. Ai vjen në Kala të Dodës edhe për të gjetur pesë kishat e famshme për të cilat flitej aq shumë në Evropën mesjetare si dhe për t'u njohur me gjurmët e një manastiri të përmendur në afërsi të Korabit. Por mjerisht, mbeti i painformuar, sepse vendasit që takoi, nuk i treguan gjë, nga që nuk kishin njohuri për to. Megjithatë takimi me Sebuli agë Radomirliun, siç tregon në kapitullin XX të librit të tij "Nëpër viset e Drinit" i la mbresa të pashlyera dhe besimin se ky vend fsheh në gjirin e tij relike të shtrenjta të një jete të perenduar.

Qëndresa e Kalasë së Dodës në luftë me pushtuesin sërb ka qenë ndër më heroiket. Në luftën e Kolosnjanit vërshuan të parët mbi 300 malësorë nga fshatrat e Kalasë së Dodës dhe nisën të parët betejën madhore, që do të shënonte dhe fitoren e parë kundër këtij shovinizmi të shfrenuar. Mbi gurët e thepisur të këtyre maleve mbeti i vrarë **Ibrahim Haxhi Zeqiri (Gjorgji),** ku dhe sot e asaj dite, aty, mes shkëmbenjve, ndodhet dhe varri i tij.

Në vitin 1920 u vra heroikisht në Sarakol gruaja trimëreshë **Naxhie Ali Murraku**, lindur më 1896 në Ceren, porsa mori vesh për vrasjen e vëllait të saj, **Ali Dodës** në frontin e Korabit. Po në këtë vit ra trimërisht po në Sarakol **Dali Ibrahim Koka** nga Ploshtani dhe **Halim Shaqir Leska** po nga Ploshtani.

Në vitin 1915 ai që shtiu i pari pushkën për të futur në kurth ushtrinë e hallakatur të Pashiqit, e cila po rrëshqiste nga Luma për të kaluar në Durrës, ishte patrioti **Mustafa Lita,** që dha i pari kushtrimin. Kjo pushkë habertare u bë edhe kushtrim për t'u grumbulluar, ashtu siç thuhet në Dibër " në shtatë e shtatëdhjetë", e për të korrë atë fitore të famshme që sot e përmendin me indinjatë edhe arkivat historike dhe muzeale të Beogradit.

Në vitin 1913 ndodhi ajo që në analet e historisë quhet **Masakra e Cerenit**.Është vendi që t'i përmendim sot gjithë këta burra të nderuar që historia të mos i harrojë: **Abaz Mahmut Leci, Daut Vesel Neziri, Hidër Sulejman Ferati, Gafurr Vesel Neziri, Rexhep Daut Flisi, Rrahman Sulejman Ferat, Sejfulla Vesel Neziri, Shaban Ramadan Gjorllaku, Shaban Rushit Brika, Vexhi Milaim Brika,** të gjithë nga Ploshtani. Nga **Cereni** u vranë: **Daut Shehat Kolgjini, Elez Ahmet Shehu,Hysen Hafuz Hafuzi,Hatib Sulejman Visha, Idriz Osman Ajazi, Idriz Ahmet Shehu, Islam Abdul Kolgjini, Jakup Jashar Hoxha, Kamber Misim Shehu, Gafurr Selim Krroqi, Mustafa Hysen Hafuzi, Murat Halil Domi, Nexhip Vesel Ajazi, Nezir Nezir Shehu, Rustem Hafuz Hafuzi, Ramadan Ahmet Kadiu, Rexhep Shaqir Domi, Rrahman Selman Sufa, Rexhep Vesel Kadia, Ymer Vehap Hafuzi dhe Ymer Tahir Ceka.** Ndërsa nga fshati **Radomrë** mbetën të vrarë: **Emin Tahir Ferati** dhe **Isuf Veli Babajku.**

RESURSET

Kalaja e Dodës ka resurse ekonomike, turistike e kulturore që janaë bërë pak të njohura deri tani. Në rradhë të parë është shumë pranë malit madhështor të Korabit me bjeshkët e mrekullueshme që ka, mu nën këmbët e tij, pejsazhe të një bukurie përrallore, që ne, unë dhe ti duhet t'ua bëjmë të njohur të gjithë atyre që duan natyrën, që duan e respektojnë bukuritë e saj. Aty kemi majat e maleve të mbuluara me borë të përhershme, aty kemi pyje shekullorë, aty kemi vendbanime shumë të hershme me interesa të veçanta antike, vende me një larmi realitetesh natyrore, që themi dendur ne, dibranët, vende ku bora zë borën. Në lartësinë mbi 2000 m ndodhen bjeshkët e mrekullueshme, si ato të Ponairit, Bjeshkët e Zonjave, Bjeshkët e Gramës, etj... Një realitetet i pabesueshëm.... Thuhet dhe është e pranueshme se Kalaja e Dodës kishte 50.000 bjeshkë dele (se bjeshka matej me numrin e deleve që mund të përballonte gjatë një vere).

Regjimi totalitar e shkatërroi Kalanë e Dodës, si gjithë Shqipërinë, por më tepër këtë zonë që përballonte nevojat e jetesës vetëm me blegtori. Tufezimi i viteve '80 e shkatërroi përfundimisht ekonominë e kësaj treve. Familje të mëdha më në zë, siç ishte ajo e Sami Isa Vishës e Vishë Vishës në Ceren, që mbarështronin mbi 2000 kokë dele, ajo e Kupajve dhe e Dakajve në Radomirë, e Likajve në Vasije, e Litajve në Ploshtan, etj. u rrënuan plotësisht. Sot ekonomitë e fshatrave të Kalasë së Dodës janë përgjysmuar dhe i gjejmë ne vise të ndryshme të Shqipërisë, më së shumti në Tiranë e gjetiu, por që kanë ruajtur më së miri traditën si punëtorë të devotshëm e si blegtorë të dalluar, që me djersë e mund kanë krijuar ekonomi kapitaliste fitimprurëse.

Tufezimi i viteve '80 e shkatërroi përfundimisht ekonominë e kësaj treve. Familje të mëdha më në zë, siç ishte ajo e Sami Isa Vishës e Vishë Vishës në Ceren, që mbarështronin mbi 2000 kokë dele, ajo e Kupajve dhe e Dakajve në Radomirë, e Likajve në Vasije, e Litajve në Ploshtan, etj. u rrënuan plotësisht. Sot ekonomitë e fshatrave të Kalasë së Dodës janë përgjysmuar dhe i gjejmë ne vise të ndryshme të Shqipërisë, më së shumti në Tiranë e gjetiu, por që kanë ruajtur më së miri traditën si punëtorë të devotshëm e si blegtorë të dalluar, që me djersë e mund kanë krijuar ekonomi kapitaliste fitimprurëse.



Shënim: **Këtë rradhë jemi mjaftuar vetëm për të përmendur disa nga veçoritë që ka Kalaja e Dodës, disa nga resurset e saj të shumta me vlera historike, kulturore dhe ekonomike. Janë shumë të mirëpritur bashkëpunëtorët tanë të na dërgojnë materiale nga më të veçantët që paraqesin interes për rubrikën tonë, jo vetëm për komunën e Kalasë së Dodës, por për të gjithë vendit e në veçanti për Dibrën.**



Drejt Dibrës, si 100 vjet më parë

Nga: **SHAQIR SKARRA**

Udhëtojmë këtë mëngjes të freskët korriku drejt Dibrës. Sa herë që njeriu niset drejt vendlindjes një ndjesi malli e kaplon gjithë qenien e tij. Sot ky rrugëtim ka të veçantën e tij, ndaj dhe malli rritet e merr përmasa më të mëdha. Kishte mes nesh që shkelnin për herë të parë në Dibër edhe pse dëshira e tyre kishte qenë e madhe për të ardhur. E ja tek nisin natyrshëm mes pyetjet : Sa orë do të zgjas ky udhëtim? Kur do të shkelim në tokën që kemi ëndërruar vite me radhë? Dikur tela me gjemba ndanin dy Dibrat e sot një realit krejt ndryshe.U ndanë nëna me djalin, vëllai me vëllanë, baba me birin e vetëm. Eh! çfarë kohe jetuam ne shqiptarët. Të ndarë e coptuar.

Sot udhëtojmë drejt Dibrës të ftuar nga vëllezërit tanë për të festuar së bashku si vëllau me vëllanë 100 vjetorin e Kongresit të Dibrës. Tamam si 100 vjet më parë kur delegatë nga të gjitha anët e vendit u nisën në këmbë e u mblodhën në Kongresin e Dibrës, ku pas shumë debatesh e diskutimesh më së fundi, me këmbënguljen e patriotëve shqiptar, u miratua programi prej 12 pikash ku ndër të tjera kryesore ishte që në shkollat që do të hapeshin gjuha shqipe të mësohej lirisht në kufijtë e caktuar. Ndaj dhe ne në gjurmë të tyre, por jo në këmbë, udhëtojmë drejt Dibrës, për ta përkujtuar këtë datë historike. Dhe jo pak, por nisemi nga Tirana 15 veta: Shabani e Nuriu, Hasani e Bashkimi, Hajriu e Vita, Hasija e Musai, Nekiu e Aliu, Shpëtimi e Edlira, Demiri e Natasha. Nuk është pak por një shekull ka kaluar që atëherë. Nuk jeton sot Vehbi Dibra, Strazimiri e Karasani, Sherif Lëngu e Ismail Saraçi, Ali Hafiz Korça e Abdyl Ypi. Sot jeton mes nesh vepra që firmosën ato dit të nxehta korriku të vitit 1909. E ndaj ftesa që na është bërë ne ka një rëndësi të veçantë, ndaj të gjithë bashkë udhëtojmë drejt Dibrës.

Makinat rrëshqasin me shpejtësi në autokolonë e biseda nis rrjedhshëm humori i hollë i Dibrës domosdo që është i pranishëm dhe mes nesh. Herë herë tingujt e një kënge popullore e largojnë vëmendjen e pasagjerëve por prapë se prapë kryebiseda është: festimet e Kongresit, kumtesat që do të mbahen e së fundi dhe mikpritja që do të na bëjnë vëllezërit tanë në Dibër. Shumica nga ne kanë dhe emocionet e vizitës së parë.

-Ndoshta do të jetë vizita e parë që po bëjmë në Dibër pa viza, thyen heshtjen Profesor Bashkim Lleshi. Nesër do të na duhen viza maqedonase për të ardhur në Dibër .

- Do t’i nxjerrim edhe vizat, vetëm të kemi aktivitete të tilla, futet në bisedë profesor Hasan Çipuri. Këto janë evinemente që nuk shlyhen lehtë nga kujtesa. Vetëm profesor Nuri Abdiu ishte i heshtur. Ishte planifikuar që të përshëndeste në emër të Shoqatës së Intelektualëve Dibranë e ndaj rrinte i menduar. I dukej vetja se ishte në një auditor me studentë por studentë të zgjedhur ama. Rruga edhe pse e gjatë, e vështirë e vende-vende e prishur askush nga ne nuk e ndjeu lodhjen. Makina u ndal e para nesh shfaqej dogana e Bllatës. Vetëm pak metra na ndanin tashmë nga qyteti i Dibrës.

Nga larg dukeshin konturet e qytetit e atij qyteti që kishim ëndërruar ta vizitonim herët por sot tek po shkelim zhgënjimi në sytë e të gjithëë dukej qartë.

“Sa keq, vëërtet sa keq po na vjen, foli Vita që shkelte për herë të parë. Këtu nuk paska vënë dorë njeri.”

MIRËSE ERDHËT NË DIBËR!

Në qytet atmosfera e festës ndjehej kudo; në rrugë, nëpër lokale e dyqane e sidomos në zyrat e komunës. Edhe pse ishte vonë pasdite kur ne shkelëm në Dibër zyrat i gjetëm hapur. Na priste kryetari i komunës, Dr. Argëtim Fida, i cili na uroi mirëseardhjen . Çdo gjë ishte e organizuar në mënyrë perfekte që nga akomodimi ynë në hotelin e llixhave në Banisht, lëvizja me makina, programi i festës si dhe darka që do të shtrohej për të ftuarit. Pas një pushimi të shkurtër në hotel përsëri ramë në qytet. Në orën 19 u bë përurimi i monumentit të Alfabetit shqip, vepër e Fitim Sulës dhe Duro Ibrahimajt. Zbulimi i këtij monumenti u bë nga zv.kryeministri i Republikës së Maqedonisë, Abdylaqim Ademi e Argëtim Fida. Tek Pallati i Kulturës do të hapej Akademia solemne kushtuar 100 vjetorit të Kongresit të Dibrës. Një ekspozitë pikture kushtuar kongresit dhe figurave pjesëmarrëse, e piktorit dibran Sabit Bocaj u pa nga të pranishmit, pastaj të gjithë zunë vendet në sallë, një sallë kjo mjaft e madhe por të vinte çudi kur e shikoje të mbushur ashtu plot edhe pse qyteti i Dibrës nuk ka më shumë se 15 mijë banorë. E gjithë salla u ngrit në këmbë kur tenori i njohur Kastriot Tusha këndoi Himnin Kombëtar. Pastaj u këndua edhe Himni i Djelmënisë Dibrane. Adivije e Islam Sharofi u përlotën në sallë tek dëgjonin këtë Himn, tekstin e e të cilit e kishte bërë babai i tyre, Haki Sharofi, ëqë në vitin 1923. Në skenë ngjitet Argëtim Fida bashkë me kryetarin e bashkisë së Peshkopisë Ilir Krosin, të cilët me një gojë e ashtu bashkë të përqafuar me njëri-tjetrin hapën Akademinë solemne me një urim: “Mirëse keni ardhur në Dibër”.

Sot udhëtojmë drejt Dibrës të ftuar nga vëllezërit tanë për të festuar së bashku si vëllau me vëllanë 100 vjetorin e Kongresit të Dibrës. Tamam si 100 vjet më parë kur delegatë nga të gjitha anët e vendit u nisën në këmbë e u mblodhën në Kongresin e Dibrës, ku pas shumë debatesh e diskutimesh më së fundi, me këmbënguljen e patriotëve shqiptar, u miratua programi prej 12 pikash ku ndër të tjera kryesore ishte që në shkollat që do të hapeshin gjuha shqipe të mësohej lirisht në kufijtë e caktuar.

Pastaj përshëndetën zvkryeministri i republikës së Maqedonisë zoti Abdylaqim Ademi, rektori i Universitetit të Tetovës Doc.Dr. Agron Reka, Prof.Dr Nuri Abdiu, kryetar i Shoqatës së Intelektualëve Dibranë, Mentor Disha nga Universiteti i Prishtinës, Ibrahim Kolari nga diaspora dibrane në SHBA, etj.

“NA PASKA MARRË MALLI”!

Edhe më 24 korrik qyteti u zgjua herët, shëtitorja kryesore ishte mbushur jo vetëm me banorët e qytetit por dhe nga të ardhurit. Dikush nëpër dyqane e dikush nëpër kafenetë e qytetit. Kryetema e ditës përsëri Akademia solemne, kumtesat që do të mbaheshin, përshtypjet e të ardhurve për mikpritjen dibrane. Së bashku me Musain, Shpëtimin, Hasijen, Nekiun e Hajriun bëmë një vizitë në Myftyninë e qytetit ku na priti Myftiu, Magjistër Rruzhdi Lata. Një kafe miqësore në këto mjedise të mrekullueshme, një vizitë tjetër në bibliotekën e Myftinisë ku u njohëm me fotografi të pabotuara më parë me pamje nga Kongresi i Dibrës.

-Na paska marrë malli bre me ndejtur bashkë vëllau me vëllanë e vet, me pi një kafe ja kështu siç po e pimë sot, tha magjistër Rruzhdiu, i cili edhe pse ora po kalonte nuk kishte dëshirë të shkëputej me ne, kishte dëshirë të qëndronte edhe më shumë. Eh sa kemi vuajtur ne shqiptarët! Çfarë fati që patëm që u ndamë njëri me tjetrin në këtë mënyrë të padrejtë. Një tjetër vizitë, në shkollën “Bashkim e vllazërim”, një shkollë krejt ndryshe me ato shkollat tona, një shkollë e ndërtuar herët por që ende i qëndronte kohës me atë projekt që kishte qenë ndërtuar qysh në vitin 1967. Në orën 10 u mblodhëm në sallën “Penestia” ku do të mbahej Konferenca shkencore. Kishin ardhur studiues e historianë nga të gjitha trevat të cilët referuan për Kongresin e Dibrës, për rëndësinë e tij dhe rolin që luajti në çështjen e arsimit shqiptar. Falë këtyre kumtesave shkencore u pastrua ajo hije dyshimi që kanë hedhur në vite mjaft historianë se Kongresin e Dibrës e organizuan xhonturqit. “Vërtet xhonturqit e organizuan për interesa të tyre tha në kumtesën e tij Moisi Kamberi nga Peshkopi, por plani i tyre dështoi që me nisjen e Kongresit. Fatet e tij dhe të vetë popullit i morën në dorë patriotët shqiptar dhe në saj të tyre u miratuan dhe 12 pikat që i vunë përfundimisht vulën Kongresit të Dibrës si një kongres të gjithë shqiptarëve. Referuan me radhë Nebi Dervishi, Mahmut Hysa, Marenglen Verli, Mehmet Malaj, Myzafer Bislimi, Rruzhdi Lata, Farudin Shabani, Rezehana Hysa. Kujtime të bukura në këtë sallë solli veterani Avni Agolli.

-Kam qenë në të njëjtën qeli të burgut me Ali Hafiz Korça. Atëherë isha i vogël e nuk dija asgjë për Kongresin e Dibrës. Për herë të parë kam dëgjuar nga goja e Hafiz Ali Korçës, i cili më fliste me mall e dashuri për dibranët, për pritjen dhe bujarinë që u bënë ato gjashtë ditë të tensionuara, për mbrojtjen dhe sigurinë e jetës që bënë dibranët për delegatët. Po çfarë fati pati ky patriot i madh. Vdiq i braktisur nga shteti në Kavajë. Kujtime mallëngjyese për të gjithë solli Adivije Sharofi: “Jam vajza e Haki Sharofit, jam dibrane e lindur në Tiranë. Jam krenare për Dibrën time dhe pse vij për herë të parë në Dibër”.

“KËSHTU U TAKOFSHIM NGAHERË”

Konferenca shkencore mbaroi. Mbaruan kumtesat, mbaruan dhe diskutimet e ndryshme nga salla. Një kujtim i bukur në shkallët e pallatit të kulturës, një fotografi e përbashkët me të gjithë të pranishmit. Kishte dhe qytetarë të ndryshëm që u futën në mesin tonë për të bërë një fotografi. Një kujtim vërtet i bukur ky që do të mbetet në kujtesën e secilit prej nesh. U larguam nga pallati i kulturës e ashtu në këmbë pa e ndjerë vapën shkuam tek varri i Said Najdenit. Në emër të gjithë delegatëve kryetari i komunës zoti Argëtim Fida vendosi një kurorë me lule tek varri i këtij rilindasi të madh dibranë. “Do të vini përsëri shpejt në Dibër, përsëri kështu do të mblidhemi kur të vendosim në qytet bustin e këtij rilindasi të madh, na tha Argëtimi”.

Në fund dreka e përbashkët e pastaj makinat ishin vënë në radhë. Të gjithë kishin dalë që të na përcillnin. Si në kor grupi organizator tek po shtrëngonte duart me ne thanë: “Kështu u takofshim ngaherë!”

veprimtari

Në qendër të qytetit të Peshkopisë, më 12 qershor 2009 u vendos busti i Iljaz Pash Qokut (Dibra), vepër kjo e skulptorit dibran, prof. Kadri Gjati, e financuar nga biznesmeni shqiptaro amerikanë, me banim në Nju Jork z. Ylber Pilku dhe familja e tij në Dibër të Madhe.

Mirë se erdhe Iljaz Pashë Qoku!

Nga: **BEQIR SINA**

PESHKOPI : Njeri prej oratorëve tha se jemi të motivuar nga ndjenja e asaj që të mbrosh dhe të rishfaqësh vlerat që ke, është një punë shumë e vështirë. Me shumë rëndësi është që pas shumë vitesh ne po rikthehemi tek promovimet, vendosjet e shtatoreve e busteve dhe propagandimi i vlerave të vërtetat historike, që ruan kjo trevë. Ne me forcën dhe sigurinë e të vërtetës historike duhet të tregojmë se pjesë shumë e rëndësishme e historisë sonë kombëtare, ku pa këtë pjesë të historisë së Dibrës, ajo di të ishte shumë e mangët.

Ne jemi ato që jo vetëm duhet t'i mbrojmë këto vlera, t'i promovojmë ato dhe t'jua përcjellim krenarinë tonë brezave që vijnë.

Këto promovime dhe përurime të shtatores se Skënderbeut, bustit të Iljaz Pashë Qokut - Dibra, etj, janë një përpjekje e madhe edhe për të pasqyruar ngjarjet, organizimet politike, ekonomiko - shoqërore, kulturore e arsimore, për figurat atdhetare të Dibrës dhe kontributin e tyre, gjatë periudhës së historisë sonë kombëtare.

Pavarësisht luftërave të shumta dhe të vazhdueshme, copëtimit të kufinjve në 1913 dhe vendosjes së perdes së hekurt nga regjimi komunist më 1948, Dibra, ende mbetet një krahinë kompakte, qendër e rëndësishme historike që vazhdon t'a ruaj kompaktësinë e saj - si rezultat i një bashkëpunim të përkryer midis dy Dibrave.

PËRURIMI I BUSTIT

Njëra prej shëtitoreve më të njohura në qytetin e Peshkopisë, e cila mban emrin e patriotit të shquara të kësaj krahine, bulevardi "Elez Isufi", segmetin e parë të këtij sheshi, të mbushur përplot me dibran dhe të ftuar të tjerë, u bë më 12 qershor 2009, përurimi i bustit të Iljaz Pashë Dibrës (Qoku), vepër kjo e skulptorit dibran, prof. Kadri Gjati, e financuar nga biznesmeni shqiptaro amerikanë, me banim në Nju Jork z. Ylber Pilku dhe familja e tij në Dibër të Madhe.

Ceremonia e përurimit u shoqërua nga banda muzikore e qytetit. Ajo ekzekutojë marshe dhe luajti antonimin e himnit kombëtar, pikërisht, në momente emocionale përpara bustit të Kryetarit të Lidhjes Shqiptare të Prizrenit, Iljaz Pashë Dibrës (Qoku). Në ceremoninë e përurimit morën pjesë strukturat më të larta të qytetit, Prefekti i Dibrës, Xhafer Seiti, Kryetari i Bashkisë së qytetit të Peshkopisë z. Ilir Krosi, deputeti i zonës Sherefedin Shehu, z. Flamur Gashi, Drejtor i Institutit Kombëtar te Diasporës Shqiptare ne Ministrinë e Punëve te Jashtme të Shqipërisë, Myftiu i Dibrës së Madhe, magjistër Ruzhdi Lata (teolog), dhe personalitete të tjera nga dy Dibrat. Për të ndjekur këtë ngjarje erdhën edhe një grup gazetarësh nga Dibra e Madhe, Atli Dema, Qenan Medinovski, Vjollca Sadiku, dhe intelektuali e veprimtari i dalluar i çështjes kombëtare, z. Ibrahim Igriu, me banim në Suedi.

> RUZHDI LATA: "...Ne sot kujtojmë në mënyrë dinjitoze, kohëra dhe momente të veçanta historike, me një avancim shumë të madh për ardhmërinë e popullit shqiptarë, njeriun që në kryesin e të cilit, u vendosë edhe hallka e parë, e themelimit të shtetit shqiptarë..."



Me një fjalë rasti pjesëmarrësve në ceremoni, iu drejtua Kryetari i Bashkisë së qytetit të Peshkopisë z. Ilir Krosi. Ai falënderoi pjesëmarrësit në këtë veprimtari dhe vecmas falënderoi sponsorin e këtij busti, familjen e Jashar Pilkut, nipërit e Iljaz Pash Qokut, në veçanti veprimtarin dhe biznesmenin e suksesshëm në SHBA-ës, Ylber Pilkun, i cili, kontribuojë drejtpërsëdrejti në bashkëpunim me bashkinë, për vendosjen e këtij busti në qendër të qytetit të Peshkopisë.

Më pas Kryetari i bashkisë ftoi z.Ylber Pilku, që së bashku të zbulonin bustin e Iljaz Pashë Qokut - Dibrës. Ceremonia e zbulimit të bustit u shoqërua nën ekzekutimin e himnit tonë kombëtar, luajtur nga banda muzikore e qytetit.

Kryetari i Bashkisë së qytetit të Peshkopisë, nderojë me një mirënjohje familjen së Jashar Pilkut, me motivacionin: "Një familje e nderuar dhe patriote, një ndër familjet e shquara të Dibrës, nipave të familjes së Iljaz Pash Qokut, që me kontributin personal financiar, kontribuan pranë Bashkisë së Peshkopisë, duke i dhuruar qytetit dhe Dibrës, këtë bust të bronxtë të Iljaz Pashë Qokut - Dibrës, kryetari i Lidhjes Shqiptare të Prizerenit".

Në emër të familjes Pilku, mirënjohjen e qytetit të Peshkopisë, e mori veprimtari i njohur në Amerikë, Ylber Pilku, i cili, pasi vlerësoi rëndësinë që ka vendosja e këtij busti në qendër të këtij qyteti, tha se "është krenar për kontributin e tij dhe të familjes së prindërve të Jashar Pilkut, duke ia rritur edhe më shumë vlerat kësaj figure të madhe historike, e cila, ishte një ndër personalitetet më të rëndësishme të Lidhjes Shqiptare të Prizerenit."

Profesor Burhan Skikuli, veteran i arsimit në Dibër të Madhe, duke folur para bustit tha: Në këtë ditë të madhe, festive e të shenjtë, kur përjetësohen figurat e mëdha historike e kombëtare, kur ditët janë ato që flasin jo vetëm përmes veprës së tyre, jo vetëm përmes historisë, por kur përditshmërisht komunikojmë me brezat për të cilat pa hezitim dhanë jetën e tyre, jemi mbledhur në këtë tubim madhështor, të shprehim me një falenderimin të madh, dhe me respekt të përkulemi përpara veprës së tyre patriotike, duke qenë krenarë që për çdo ditë do t'i kemi pranë për t'u dëshmuar breznive, se historia e kombit tonë, është shumë e lavdishme. Ndaj sot, tha Skikuli, në këtë ditë të bukur qershori, realizohet ngritja dhe vendosja e përmendores së patriotit Iljaz Pashë Qoku - Dibra, që do t'a zbukurojë edhe më shumë qytetin e Peshkopisë.

Në këtë ceremoni, tepër të ngrohtë dhe emocionuese kanë tingëlluar edhe fjalët e Myftiut të Dibrës së Madhe, magjistër Ruzhdi Lata. Myftiu i Dibrës së Madhe Ruzhdi Lata tha se; "Kam nderin që t'ju përshëndes, në këtë moment historik për dibranët, e në veçanti qytetarët e Peshkopisë. Ai tha se nëse kemi të bëjmë ashtu si dhe thotë rilindësi i madh Sami Frashëri, se " Një popull që nuk mëson nga e kaluara e tij historike, Zot na ruaj, është i destinuar të bjerë viktimë e historisë - dhe t'i ripërsëritet historia". "Ndaj, ne sot kujtojmë në mënyrë dinjitoze, kohëra dhe momente të veçanta historike, me një avancim shumë të madh për ardhmërinë e popullit shqiptarë, njeriun që në kryesin e të cilit, u vendosë edhe hallka e parë, e themelimit të shtetit shqiptarë, çka do të thotë, Iljaz Pashë Dibra - Qokun, atij kreatori që së bashku me Abdyl Frashërin dhe shumë burra të tjerë, në Kuvendin e Prizrenit, u munduan e thurën që për herë të parë të formohet një hallkë e shtetit shqiptarë." Ajo, tha Lata, e cila do të shtynte edhe më përpara, me kalimin e viteve në dobi të çështjes kombëtare nga burra të tjerë, deri në këto momente që jemi, për të arritur një ditë që të kemi një shtet të vetëm shqiptarë."

Më pas, magjistër Lata, nënvizojë se "deshi perëndia, që u formua për herë të parë një ambient i lirë dhe europian shqiptarë, edhe ekonomikë e politikë, të gjendën njerëz, të cilët, ditën që në një formë apo tjetër të ringjallën edhe këtë figurë të shquar të asaj lëvizje kombëtare, pra sipas tij ringjalljen e Iljaz Pashë Dibrës, për të patur të gjallë idenë dhe mendimin e tij historik në ndërtimin e shtetit të shqiptarë.

Pra, tha Myftiu i Dibrës, Ruzhdi Lata, "Për të mbajtur gjallë këtë figurë dhe këtë kujtesë kombëtare duhet mend dhe dëshirë, duhet punë dhe një ambient, këtu në meset tona, si ky që ka krijuar edhe kryetari i bashkisë së Peshkopisë, e të gjithë ata që kontribuan dhe u angazhuan në këtë ambjet të mirëfilltë politik, që të themi "Mirëseerdhe në Dibër" përsëri Iljaz Pashë Qokut - Dibrës.

Kështu që tha ai, me siguri që kur të kalojmë këtij bulevardi - dhe do të kalojmë shpesh, patjetër që do të përulemi përpara këtij busti pa rezerva, duke u krenuar para të tjerëve, për të mësuar edhe historinë tonë dhe fshirë një herë e mirë nga mremorja jonë të gjithë ata që u munduan të hedhin baltë ndaj kësaj figure kombëtare.

"Ndërsa, ceku Lata, ata që hodhën baltë, ndoshta do të skuqen pak, para kësaj figure, se do të jetë në nderin e tyre, ngase Iljaz Pash Dibra, në perandorinë Osmane, pati një qëndrim karshi një rezistence të jashtëzakonshme, duke marrë parasysh rrethanat e kushtet e atëhershme. Kështu që ne do të vazhdojmë bashkërisht që në këto troje, të cilat kanë lindur e burrëruar dhe shumë Iljaz të tjerë, me idealin dhe mendimin e tij. Dhe ashtu si po na bashkon kjo ditë me inaugurimin e bustit të Iljaz Pashë Dibra - Qokut, të bashkohemi e të takohemi për të nderuar dhe respektuar edhe ato ideale dhe mendime në shpirtrat e zemrat tona", ka përfunduar fjalën e rastit, Myftiu i Dibrës së Madhe, magjister Ruzhdi Lata.

SIMPOZIUMI DHE EKSPOZITA

Gjatë ceremonisë u hapë edhe një ekspozitë, ku me referat shkencor, u paraqitë drejtori i Muzeut të qytetit të Peshkopisë, Moisi Kamberi, dhe historiani Nebi Xhembulla. " Dibra, është krahinë që ndodhet në qendër të Shqipërisë etnike, tha Kamberi, pozicion gjeografik, ky që u ka mundësuar dibranëve marrëdhënie dhe kontakte të gjëra me të gjitha krahinat brenda dhe jashtë Shqipërisë dhe që nëpërmjet këtyre kontakteve, dibranët kanë shkëmbyer arritjet më të përparuara në fushën ekonomike, politike, kulturore e arsimore, që nga lashtësia e deri në ditët tona."

Ndonëse, tha ai gjatë gjithë historisë pushtuesit janë përpjekur t'a izolojnë, Dibra asnjëherë nuk i ka shkëputur lidhjet dhe marrëdhëniet e krahinat e tjera. Ndërhyrja e Dibrës dhe e dibranëve në momente të veçanta të historisë kombëtare, sipas tij ka qenë përcaktuese dhe vendimtare për fatin e shqiptarëve.

Ai tha se zhvillimet e brendshme dhe tepër interesante, kontaktet e pasura rajonale të Dibrës janë mundur t'i prekin, pa arritur t'i interpretojnë, edhe shumë studiues të huaj që kanë kaluar apo kanë qëndruar në këtë krahinë. Ata njohën dhe vlerësuan zhvillimin e krahinave të Dibrës dhe civilizimin e banorëve të këtyre trevave, besnikërinë, traditat luftarake, intuitën e mikpritjen e tyre bujare.

Në odat e burrave, në kuvendet tradicionale, ata qenë dëshmitarët se si dibranët, nëpërmjet mirëkuptimit e tolerancës, arrinin të falnin gjaqet dhe të lidhnin besën kur fatet e atdheut kërcënoheshin dhe trojet ishin në rrezik të copëtoheshin nga pushtuesit. Dibra, gjatë gjithë historisë së saj, mbrojti trojet dibrane e shqiptare nga copëtimi dhe asimilimi i pushtuesve të huaj.

(Vijon në faqen 15)



Në foto: Mehmet Pilku, Mahmut Pilku,Sadik Pilku, Ramiz Pilku, Nazif Pilku dhe Sali Pilku, në Kuvendin e Dibrës - 20 Tetor 1880

Intervistë me mjeken dermatologe Monika Fida (Zebi):
Një shoqëri emancipuar duhet të krijojë hapësira
e mundësi për të mos u ndier aspak diferencimi gjinor

Dashuria që lindi nga një libër anatomie

Monika Fida (Zebi) ka lindur në qytetin e bukur të Peshkopisë dhe ende ka mall për aromën e bukur të blirëve në bulevard dhe akulloren e dikurshme tek turizmi nën melodinë e orkestrës. Pasi përfundoi me nota të mira gjimnazin vazhdoi studimet në Fakultetin e Mjekësisë ku më pas u specializua mjeke dermatologe. Ka kryer mjaft specializime të tjera në fushën e dermatologjisë, në universitete të njohura jashtë vendit si në Harvard –USA, Graz-Austri, Romë-Itali. Sot është një nga mjeket më të njohura dermatologe si dhe pedagoge në Universitetin "Zoja e Këshillit të Mirë"



Si ka qenë fëmijëria juaj? Po adoleshenca?

Fëmijërinë dhe adoleshencën do t'i përkufizoja si një kohë shumë e lumtur për mua. Kam qenë më e vogla dhe më e përkëdhelura në familje. Në Peshkopi vërtet kam kaluar vite shumë të bukura që kujtesa ime i ruan ende me fanatizëm. Kam qenë ajo nxënësja e dalluar që këndoja në festivale, i bija violinës, rrëshqisja me ski, luaja volejboll e pingpong. Pra, me një fjalë kam qenë shumë aktive. Dhe sigurisht këto t'i afronte vetëm një qytet si Peshkopia.

Çfarë dëshironit që të bëheshe kur ishit e vogël?

Shpesh mendoja që të bëhesha mjeke, por kam qenë ca e papërcaktuar. Vetëm gjatë viteve të gjimnazit dëshira për këtë profesion u forcua më shumë.

Profesionin e zgjodhët vetë apo ndikuan prindërit tuaj?

Prindërit e mi, duke qenë intelektualë, ndikuan shumë në formimin tim të përgjithshëm, por profesionin e zgjodha vetë. Shpesh kur studioja për konkurim e lodhesha shumë, mamaja më lutej shpesh të merrja Juridikun, por asnjëherë nuk më ka pëlqyer diçka që arrihej lehtë. Prindërit sigurisht që më kanë ndihmuar jashtë mase gjatë gjithë studimeve të mia, ju jam shumë mirënjohëse.

Njohja me bashkëshortin, si e kujtoni atë ditë?

Edhe pse kanë kaluar mjaft vite ende për mua është si diçka e pabesueshme, pasi të dy jetonim në të njëjtin pallat e njëri-tjetrin e njihnim mirë, por ne të dy jemi njohur në fakt në fakultet. Eshtë paksa e pabesueshme që ne jetonin në të njëjtin pallat, familjet e njëri-tjetrit i njihnim mirë, por vetë jemi njohur në fakultet. Atë ditë në librarinë e fakultetit unë po gërmoja të gjeja ndonjë nga librat poshtë banakut. Shpesh qeshim me miqtë për këtë njohje dhe përgjërimet e mia për një libër anatomie. (Në vitin 1992 nuk ishin këto mundësi për të blerë apo fotokopjuar libra).

Bëni shpesh dhurata, po bashkëshorti juaj?

Bëj shumë dhe gëzoj kur bëj dhurata, ndoshta po aq sa ai që merr një dhuratë. Bashkëshorti im disi më ndryshe, më bën dhurata në raste shumë speciale, por për të tjerët kujtohem unë.

Çfarë profesioni keni dëshirë të marrin fëmijët tuaj ?

Vajzat do të doja të bëheshin mjeke, megjithëse e di që është një rrugë shumë e lodhshme, por që të jep më shumë kënaqësi. Për djemtë do të doja të trashëgonin nga gjyshi talentin e përkushtimin që të bëheshin inxhinier ndërtimi që ndoshta të çonin më tej dhe punën dëshirën e tij.

Për çfarë të merr malli më shumë tani që jetoni larg vendlindjes ?

Sinqerisht më merr malli për aromën e blirit në bulevard dhe më pas për akulloren e turizmit nën melodinë e orkestrës.

"Ne nuk duhet të presim vetëm nga të zgjedhurit por duhet të përkrahim dhe promovojmë njëri - tjetrin. Dibranët kanë vlera, por këto vlera duhet të promovohen qoftë në media, qoftë dhe në aktivitete të ndryshme. Vetë nismat e gazetës tuaj për të njohur dhe promovuar intelektualët, për të njohur me tepër rreth punës e arritjeve të tyre duhet përgëzuar e përkrahur..."

Çfarë mund t'i afrojë sot Shqipëria një intelektuali, po intelektuali çfarë roli duhet të luaj?

Sigurisht që sot Shqipëria ka ndryshuar dhe i afron më shumë se vite më parë një intelektuali. Megjithatë unë kam përshtypjen që intelektualët duhet të bashkohen e larg bindjeve partiake e interesave vetjake të bëjnë më shumë për këtë vend.

Keni menduar ndonjëherë të largoheni nga Shqipëria ?

Unë faktikisht kam jetuar jashtë rreth 4 vjet dhe jam kthyer prej tetë vitesh tashmë. Udhëtoj shpesh nëpër kongrese ose specializime, marr ato që më duhen jashtë (dijet) dhe përsëri vij të jetoj këtu pranë atyre që më duan dhe i dua shumë.

Sot familja ndihet mjaft e trazuar dhe kjo duket tek adoleshentët, të rinjtë, të rriturit por dhe tek mosha e tretë. A mendoni se në përpjekjet për t'u bërë pak sa modern familja shqiptare po humbet disa nga vlerat e saj më të çmuara, nëqoftëse po? Kush ka ndikuar më shumë në këtë mes?

Po është më se e vërtetë që po jetojmë një kohë disi të trazuar, por kam bindjen që kjo ndihet sidomos në ato familje që nuk kanë baza të shëndosha dhe që nën termin modern po shkatërrojnë vlerat. Ndikon sidomos formimi jo i plotë i individit që anti vlerat i duken si vlera dhe nuk arrin të diferencojë atë ç'ka është e moralshme. Shpesh vihem në vështirësi dhe vetë e pyes veten a jam ne rregull-por faktikisht përgjigjen e gjej tek poezia e Kipling "Në mundsh".

Çfarë mund të na thoni për gjendjen dhe rolin e femrës shqiptare sot në shoqëri?. Gratë dhe politika si i shikoni përballë njëra tjetrës?

Femra sigurisht që është faktor në shoqëri por shpesh tek ne nuk ka barazi shoqërore dhe vërehet maskilizmi i ndjeshëm. Një shoqëri emancipuar duhet të krijojë hapësira e mundësi për të mos u ndier aspak diferencimi gjinor. Në se më shumë gra do të ishin pjesëmarrëse aktive në politikë atëherë sigurisht që hapat përpara do të ishin më të mëdha.

Profesioni i mjekut me politikën ku bashkohen dhe ku ndahen ato?

Përkushtimi dhe puna e palodhur në shërbim të komunitetit i bashkon por ndahen kur politikanët venë interesat personale mbi ato të popullit gjë që ndodh rëndom sot e mjekët janë gjithmonë në shërbim të jetës së njeriut.

Sot në Tiranë ka një komunitet të madh dibranesh. A mendoni se ka ardhur koha që dibranët të kenë lobingun e tyre pasi kemi parë shpesh që deputetët këto përfaqësues të popullit që u kemi dhënë votën nuk bëhen pjesë e shqetësimit tonë? Sa kanë punuar intelektualët dibranë për një gjë të tillë?

Sigurisht që po. Ne nuk duhet të presim vetëm nga të zgjedhurit, por duhet të përkrahim dhe promovojmë njëri - tjetrin. Dibranët kanë vlera, por këto vlera duhet të promovohen qoftë në media, qoftë dhe në aktivitete të ndryshme. Vetë nismat e gazetës tuaj për të njohur dhe promovuar intelektualët, për të njohur me tepër rreth punës e arritjeve të tyre duhet përgëzuar e përkrahur. Mbetet që vetë ne të bëjmë më shumë për lobingun tonë.

Mendimi juaj për gazetën "Rruga e Arberit"?

Gazeta është një copëz e dashur nga vendi im. Misionin po e kryen më së miri, po na bashkon ashtu siç ka dhe emrin e rrugës që do të na afrojë më pranë qoftë me njerëzit, ashtu edhe me ato vise të bukura që vërtet ndjejmë mallë. Ju faleminderit.

Bisedoi: Shaqir Skarra

Tregime alegorike dibrane

Të folurit e tregimet alegorike (meseletë) në Dibër etj., njihen prej shekujsh. Por kjo mënyrë e të folurit mori një zhvillim të madh, sidomos në shekullin e 19-të, në kuvendet, mexhliset dhe odat dibrane.

E folmja me mesele, me ngjarje që i përshtaten llafit-thuhet se ka lerë në Dibër. Malësori dibranë nuk ka bërë llafe sikur shtie me pushkë shpejt e shpejt. Por llafi në kuvend bëhej avash-avash. Këto biseda – thuhet në historinë dibrane kanë lindur në kushte të caktuara historike dhe janë një pasuri shpirtërore dhe thesare të çmuara e me vlera të mëdha aktuale jo vetëm për trevën e Dibrës, por edhe për pasurimin e kulturës sonë kombëtare. Këta janë shumë domethënëse dhe kanë një kuptim të thellë që rrallëkush i kupton.

Ja disa prej tyre:

- Njëherë një pasha turk u nis për në luftë. Ra poshtë në një përrua. Aty gjen një mullixhi dhe i thotë: Bre sa rehat qenke ti këtu. Mos u tal me mua or pasha – ia ktheu mullixhiu. Unë nuk jam pasha si ti. Si të duash i ndërrojmë rrobat – i tha pashai. Unë bëhem mullixhi e ti bëhu pashë. Kështu mullixhiu u vesh si pasha dhe i priu ushtrisë. Lufta u ndez e ashpër. Nuk shkoi shumë dhe mullixhiut i bie një plumb në kokë. Menjëherë i bëjnë zë doktorit. Ky erdhi me vrap dhe iu afrua pashait (mullixhiut që ishte veshur si pasha) dhe tha: Nuk e ka preku plumbi në tru. Mullixhiu i veshur si pasha ngriti kryet e tha: Po të kisha tru kisha ndejt në mulli e nuk kisha ardhur këtu. Kuptimi: Nëse nuk i aftë për atë detyrë që të ngarkohet, mos e merr përsipër, se do ta pësosh, siç e pësoi mullixhiu i veshur si pasha.

- Në odat dibrane burrat qëndronin këmbëkryq pa u mbështetur. Kjo tregonte shenjë kulture dhe respekti për të gjithë vallen e burrave. Një qëndrim i kundër me të, mund të bëhej objekt bisede e debati. Ja një tregim për këtë mesele: Njëri prej miqve i drejtohet të zotit të konakut: Or Xhemë, kur po vija këtu pashë se njëri nga mullarët e barit ishte rrëzuar e kishte rënë përtokë. Po – iu përgjigj Xhema, mund të ketë rënë vërtetë se barë ka pasur shumë e druri i mullarit ka qenë i dobët. Po do t'i vemi dy druna të tjerë e do ta ngremë. Ishte fjala për njërin nga miqtë që ishte mbështetur dhe e kishte zanë gjumi.

- Një babë kishte një djalë. Ky ishte shumë i prapë. Çdo ditë i ati i thoshte: More djalë nuk je tue u bërë njeri. Ke për të parë se ç'njeri do të bëhem or babai i thoshte djali. Një ditë ky djali ikën prej shtëpie e bashkohet me do njerëz të hurit e të litarit. Tani po bënte prapësira më shumë. Vidhte e vriste njerëz etj. Një ditë ushtria turke e kapi dhe e burgosi. Mbas do kohe djalin e liruan nga burgu. E vunë në krye të një komande për të ndjekur "kaçakët" arnaut. Ky djali dallohet në këtë detyrë e turqit i japin gradën e pashait. Më vonë e bëjnë Vali dhe i thonë se në ç'vilajet donte me shkue. Ai zgjodhi vilajetin ku kishte familjen e vet. Si bani nja dy javë në detyrën e re, i thotë një zabiti: Shko në filan kaza, në filan katun e të më biesh filanin këtu. Shkon zabiti dhe e gjen të atin e valiut tue lërue me qe në arë e ashtu siç ishte këmbëzbathur dhe e çon në qendër të vilajetit. Valiu e pyet: A më njeh mua kush jam? Ndalu njëherë sa të mbushem me frymë, se më kanë tërhequr rrëshqanas ata njerëzit e tu – i thotë plaku. Mbasi qetësohet disi përsëri Valiu i thotë: Po tani a më njeh? Ngrehu në këmbë që të të shoh më mirë – i thotë plaku. Valiu u ngrit në kambë dhe plaku e pa më mirë. Tani të njoh – i tha plaku. Ja pasha turk. Jo pasha por vezir – tha djali. Jam djali yt. A mban mend si më thoshe: "Kurrë nuk ke për t'u ba njeri nuk dilje kundra vendit tënd e kundër babait tënd, që e more rrëshqanas dhe e solle këtu. (Besoj se nuk është nevoja për koment, pasi rreshtat e fundit flasin qartë për to). Ndaj nuk i thonë kot: Atë që të bën fëmija, nuk ta bën as Perëndia, si për mirë, ashtu edhe për keq. Dhe sjellja ndaj prindërve është gjëja nga më kryesoret në jetë. Mjerë ato e të tjerët nga njerëz të tillë.

- Një djalë i ri kishte shumë shokë, që i shkonin dhe i vinin shpesh te shtëpia. I ati i këtij djalit fillon me dyshu dhe don me i provuar a ishin miq e shokë të vërtetë. I thotë të birit: Kam vrarë një njeri dhe e kam fshehur në hauer (hajat). Ku rta marrin vesh njerëzit e tij do të vijnë e të na vënë pushkën. Shko ke shokët e tu e thirri të vijnë në kullën tonë e bëhemi shumë pushkë. Djalin shkon te gjithë shokët e u thotë se çfarë i kishte ndodhur familjes së tij. Po asnjëri nga ato nuk erdhi, tue nxjerrë lloj-lloj pengesash. Hë more djalë – i thotë i ati: A të erdhën shokët. Jo nuk erdh asnjëri – tha djali. Mirë pra, shko e thirr filanin e filanin e u thuaj se ç'na ka gjet. Ata janë shokët e mi e ke për të parë se si do të përgjigjen. Shkon djali dhe i thirri të tre shokët që kishte plaku. Ata kapin pushkët dhe nisen pas djalit. Atëherë babai i djalit u thotë atyre. Hajdeni në hajat e ta shohim njeriun e vrarë. Kur hynë në hajat, hoqën degët e thata dhe panë një dash të rrejpeur.

(Vijon në faqen 14)

profil



Bashkëshortë dhe afaristë të shkëlqyer

Shpresa dhe Mexhit Capa: "Objektiv yni është ndërtimi edhe nga një hotel me pesë yje në Banisht dhe Kosovrast së bashku me poligonet sportive rekreative"

Bashkëshortët Mexhit dhe Shpresa Capa, ekonomistë të diplomuar, i pari pronar dhe president i bordit të Banjave, ndërsa e dyta menaxhuese e Banjës së Banishtit, janë shembull i shkëlqyer i një binomi afaristësh shembullorë. Kjo vërehet që në takimin e parë me ta, nga mikpritja, përzemërsia dhe aftësia e tyre e përkryer në punën që e kryejnë. Kjo dëshmohet edhe me suksesin e tyre në menaxhimin dhe investimet në këto banja.

Dibrës së Madhe natyra ia ka dhuruar ujërat termominerale në lokalitetet e Banishtit dhe të Kosovrastit. Përbërja e pasur kimike dhe radioaktive e ujërave, karakteristikat e tyre mjekuese të shoqëruara me kujdesin mjekësor e terapeutik, klima e përshtatshme dhe mjedisi magjepës, janë bërë joshëse për vizitorë, të cilët vijnë për të shëruar sëmundje të ndryshme, por edhe për të pushuar dhe për tu çlodhur. Përkundër krizës ekonomike globale, shikuar sipas çmimeve dhe prenotimeve edhe ky vit pritet të jetë shumë i suksesshëm, duke arritur 72 mijë buajtje.





Në foto: Shpresa Capa dhe Mexhit Capa. Lart: Banjat e Kosovrastit.

MJEKIM DHE REHABILITIM ME SPEKTËR TË GJERË

Përbërja termominerale e ujërave dhe veprimi shërues i këtyre banjave, i radhit ato në më të njohura në botë. Sipas institutit AKAO të Zvicrës që merret me studimin e banjave termominerale, ujërat e Banjave të Dibrës së Madhe-Capa kanë një kompleksitet të përbërjes kimike, të squfurit, radioaktivitetit, të mineraleve të ralla e të gazrave zbërthyese, që i bëjnë të jenë më efektive në kurimin e shumë sëmundjeve.

Efekti më i sukseshëm i ujit termomineral të Banjave të Dibrës së Madhe-Capa arrihet te sëmundjet reumatike, të aparatit lokomotor, te sëmundjet e organeve gastrointestiale, te sëmundjet e organeve respiratore, te sëmundjet e sistemit kardiovaskular, te sëmundjet e veshkave dhe të organeve urinare, te sëmundjet gjinekologjike, te sëmundjet endokrine (të sheqerit), të sëmundjet e sistemit nervor dhe te sëmundjet e lëkurës.

Veprimi shërues i ujit termomineral në Banjat e Dibrës së Madhe-Capa , procedurat e terapisë fizikale, baltës mjekuese dhe kushtet e tjera optimale në këto objekte bashkëkohore, ofrojnë mundësi për kurim, rehabilitim dhe rekreacion të një niveli të lartë cilësor.

TRE MILIONË E 400 MIJË EURO INVESTIME

Mexhit dhe Shpresa Capa, deklarojnë se:" Privatizimi banjave u krye në tetor të vitit 2004, ndërkaq deri në korrik të vitit 2008 kemi investuar 3 milionë euro në rikonstruksion e objekteve hotelerike dhe të pishinave. Bëmë mbulimin e 1000 metra katrorë të të gjitha pishinave me çati. Në pranverën e vitit 2005 bëmë rikonstruksionin e 38 dhomave me 86 krevatë, të nyjeve sanitare, banjove, inventarit, suvatimin e mureve të Bllokut A në Banjën e Banishtit. Në vitin 2006 bëmë rikonstruksionin e 72 dhomave me 176 krevatë në Hotelin "Termal" në Banjën e Kosovrastit. Në vitin 2007 po në këtë banjë u ndërtua edhe një pishinë. Ndërkaq në Banjën e Banishtit u ndërtuan 2 pishina të reja e 10 vaska dhe u instalua tërë rrjeti elektrik dhe aparaturat elektrikë bashkëkohore.

Në vitin 2008 u bë rikonstruksioni i kuzhinës dhe aneksit prej 600 metra katrorë në Banjën e Banishtit, dhe ndërtuam 18 dhoma të reja me 54 shtretër. Në Banjën e Banishtit dhe të Kosovrastit janë ndërtuar fitnes sallat e kompletuara me tërë rekuizitat e kohës.

Ata më tej, shtojnë se, "Në qendër të qytetit kemi ndërtuar hotelin "Uraniku" me sallën e restorantit për 500 persona, sallën për mbajtjen e konferencave të ndryshme për 250 persona, një kat për zyrat e të punësuarve, vendparkimin, taracën e hotelit, dhe këndin me lojëra për fëmijë. Në Banjën e Banishtit në ndërtim e sipër është trim staza dhe stadiumi sportiv, ndërsa në atë të Kosovrastit do të ndërtohen poligone sportive.

Në gjashtë muajt e parë të vitit 2009 janë investuar edhe 400 mijë euro në ndërtimin dhe pajisjen më bashkëkohore të edhe 18 dhomave të reja në Banjën e Banishtit, në blerjen e aparaturave të reja fizioterapeutike për dy banjat, në rregullimin e taracave, fontanave, lulishteve dhe shitoreve.

Objektiv yni, thonë ata, është ndërtimi edhe nga një hotel me pesë yje në Banisht dhe Kosovrast sëbashku me poligonet sportive rekreative".



SHQETËSIME PËR TË DREJTËN E SHFRYTËZIMIT TË UJIT, ELEKTRIKUN DHE TELEFONINË

"Ne kishim bizneset tona të fuqishme me miell e mazut në Shqipëri, por dëshira e flaktë për vendlindjen na orientoi të bëhemi pronarë të Banjave të Dibrës së Madhe, e të përqëndrohemi të investojmë këtu. Për shërbimet tona i kemi angazhuar subjektet vendase. Furnizimin me artikuj ushqimorë e bëjmë nga tregtarët dibranë, edhe ndërtimin dhe rikonstruksionin e objekteve e bëjmë me firma dibrane, që ta ndihmojmë biznesin dibran", shprehen Mexhiti dhe Shpresa Capa.

Ata nuk ngurojnë të përmendin edhe burokracinë e Ministrisë së Ekonomisë së Maqedonisë, e cila Banjës së Katllanovës ia dha lejen për shfrytëzimin e ujit që në vitin 2006, ndërsa përkundër shumë intervenimeve dhe premtimeve, neve kjo leje ende nuk na është dhënë. Kemi shumë vërejtje edhe rreth difekteve me energjisë elektrike dhe me telefonat, për shkak të mungesës së ekipeve përkatëse. Jemi të detyruar që agregatët tonë t'i vemë shpesh në përdorim, ndërsa po shikojmë mundësinë që të sigurojmë edhe lidhje telefonike me Shqipërinë, thanë ne fund, Mexhit dhe Shpresa Capa, pronarë dhe menaxhues të Banjave të Dibrës së Madhe.

SHUMË TË PUNËSUAR DHE SHKOLLIM KUADROSH

"Të gjitha këto investime kanë bërë që, deri tani numri i të punësuarve të arrijë 176 persona me tendencë rritje. Nuk mungojnë as investimet për specializimin e mjekëve në Universitetin e Shkupit dhe të studentëve në Universitetin Shtetëror të Tetovës, duke llogaritur pagat e specialistëve, taksën e shkollimit, bursat e studentëve dhe udhëtimet, sepse siç thonë ata, pa kuadro të mirfillta nuk mund të ketë shëbime cilësore. Në Banjat e Dibrës së Madhe vijnë të trajnohen edhe kuadro nga Shqipëria", thonë këta menaxhues të vyer.

SHTIM I KLIENTËVE VENDAS DHE TË HUAJ

Siç theksojnë Mexhiti dhe Shpresa: "Viteve të mëparshme pjesa dërmuese e vizitorëve ishte nga Lugina e Pollogut, pas privatizimit dhe investimeve që kemi bërë, se vjen e rritet numri i klientëve nga Maqedonia, Shqipëria, Kosova, Suedia, Italia dhe Çekia".

Rexhep TORTE

Stafetën e Cen Lekës në luftrat për çlirim, arsim, e përparim e vazhduan Mustafa Leka, Man Leka, Rrahman Leka, Demir Leka etj. Në gjurmët e Cen Lekës këta patriot u bashkuan në lidhjen e Dibrës, Lëvizja e Plugut (Gropa e Ujkut) luftën për demokratizimin e jetës së vendit, luftën Nacionalçlirimtare...

ME RASTIN E 165 VJETORIT TE BETEJES SE DRINIT

"Burri i dheut" Cen Leka

Nga: **ZABIT LLESHI**

Beteja e Drinit 1844 ishte një epope e lavdishme e luftës së Dibrës ndaj Perandorisë Osmane, luftë kjo e pabarabartë në ushtri e armatim. E në fakt fitoi kauza e drejtë ajo që mbronte tokën, vatanin,nderin dhe dinjitetin. Sa më shumë largohemi në vite, aq më lart ngrihen figurat dhe prijësit popullor, që udhëhoqën popullin tonë në këto beteja të përgjakshme.Ato në fakt nuk kishin akademi ushtarake për drejtimin e luftës por kishin zemrat dhe sakrificat e patriotëve që i mbështetën gjithmonë kur ishte fjala për luftë kundër pushtuesve e armiqve të shumtë.E njëri ndër to ishte dhe Cen Mustafa Leka .Ishte biri i një fisi të njohur në fshatin Zogje (Grykë e Vogël).Fisi Leka së bashku me fiset e tjerë Markja e Lleshi kanë dhënë një kontribut me vlera të mëdha në luftrat e popullit tonë për liri e pavarsi ku gjithmonë kanë spikatur prijësit e tyre herë nga njëri fis e herë nga fisi tjetër.Cen Leka lindi në shekullin e 18-të(1790), në një familje me varfëri të thellë por bujare e me zemër të madhe. Që në moshë të mitur shquhet për një zgjuarsi, ku do të dallohej mes moshatarëve për një pjekuri të parakohshme dhe aftësi organizative efikase, që do të përgatiste patriotin e ardhshëm vizionar të guximshëm. Në brumosjen dhe kalitjen e këtij patrioti ndikuan edhe ambientet patriotike në të cilën ai u rrit, pjesmarrja në Gjurrë të Mazhicës, Zogje, Shupenzë, Maqellarë, Dibër të Madhe, të organizuara kundër sistemit Osman.Veprimtaria patriotike e Cen Lekës dhe karakteristikat e figurës që përmendëm më lart i bindën përfaqesuesit të Grykës së Vogël për ta zgjidhur si prijësin e saj. "Burri i Dheut" quhej tashmë kryetari i maleve që pati nderin të udhehiqte shpeshherë dhe jo vetëm luftën por edhe bisedimet me osmanllinjtë në situata luftimesh duke mbrojtur me dinjitet kërkesat e shqiptarëve ndaj Perandorisë Osmane. Në fillimet e vitit 1844 u zhvilluan luftime midis forcave osmane dhe maleve të Dibrës në Mavrovë, Vllajnicë e Kërçovë. Humbjet që pësuan pushtuesit e bindën Perandorinë Osmane të marrë masa të reja për përgatitjen e shtimit të forcave të shumta në numër e teknikë luftarake. Në këto kushte malet u përgatitën për luftë të gjatë me moton "Nizamë e Xhelepe s'ka, është vendi fukara".

Perandoria Osmane nën komandën e Hajredin Pashës në korrik të vitit 1844 dërgoi drejt Dibrës forca të mëdha. Kjo situatë u diktoi maleve takimin tek kalaja në Homezh.U morën masa, vendime dhe u lidh besa që Hajredin Pasha të pritej me luftë.

Fillimisht Hajredin Pasha duke njohur shpirtin patriotik të këtij populli të vuajtur por të bashkuar e të vendosur në kërkesat e tyre kërkoi të hynte në bisedime me mendimin se mund t'i përçante malet dhe t'i nënshtronte pa luftë. Përfaqësuesi i maleve për bisedime u caktua Cen Leka. "Burri i Dheut" Situata ishte e tensionuar.....Ceni dhe pse i vetëm e ruajti qetësinë dhe në mënyrë të prerë i komunikoi Hajredin Pashës vendimin e maleve të Dibrës:

-Kemi vendosur të mos japim as nizamë e as taksa....po kalove Drinin nuk fol më goja por pushka.-1) (M.Murra. Dibra Etnokultura VII fq 195).

Për të larguar Cen Lekën si prijës i maleve Dibrane Hajredin Pasha i premtoi një rryshfet të majmë, që nuk u pranua duke e këshilluar Pashën të largohej një orë e ma parë, ndryshe do të bëhej gjaku gjer në gju. Në këngën popullore kjo shprehet dhe me vargje:

"Hajredin Pasha mor hajvan
nuk shitet Ceni me alltan"

Me qenë se bisedimet hynë në vështirësi Pashai futi në përdorim diplomacinë duke përdorur dinakërinë siç e kishin zakon pashallarët."Stambolli është lajmëruar se Dibra është nënshtruar i tha Pashai Cenit për të ndaluar vrullin e prijësit.


"Pashë..Pashë! Dibra është në këmbë prandaj njofto Stambollin se për Dibrën lajmi është i rremë...i bërtiti Cen Leka duke treguar me gisht Grykën e Vogël. Ultimatumi i dhënë Hajredin Pashës është shprehur në vargje si ma poshtë:
"Malet e Dibrës në këmbë janë çue
Ja me vdek, ja me shpëtue"

Me keto fjalë ndahet nga Pasha Cen Leka, ndërsa kurthi ndaj tij ishte pregatitur me parë. Ushtarët që shoqëronin Hajredin Pashën kërkuan që Cen Lekën ta vinin përpara trupave me qëllim që malësorët të mos qëllonin mbi ta. Vonesa e Cenit iritoi kryengritësit dhe 75 luftëtarë nga Zogjet me në krye Zenel Lekën, kaluan Drinin dhe u ndodhën para mullirit të Rustem Begut në Sollokic. Këtu përballen me ushtrinë e Pashait, ndërsa para tyre ecte vetë Cen Leka i cili u tha:

"Ju për mue gajle mos kini
Qenit t'zi o burra bini"
(Dibra Etnokultura VII fq 195).

Përpjekja me luftuar trup me trup më 23 korrik 1844 në Sollokiç ishte ndeshja e parë që solli humbjen e 2500 dibranëve, duke e çvendosur fushën e betejës në Gjoricë .Bashkë me luftëtarët trima u vra dhe Ceni me të birin Metën:
"Se kur të ngrihen t'nantë malet mbarë
Mos ndodhtë Meta ma gjallë"

Lufta kundër Hajredin Pashës e nëntë maleve të Dibres (Lufta e Drinit) ka hyrë në historinë e Shqipërisë si një epokë e lavdishme që tronditi themelet e Perandorisë Osmane, jehona e fitores kundër Hajredin Pashës (Ushtria e tij numëroi rreth 12.000 të vrarë) i kaloi kufijtë e trojeve Shqiptare. Kënga e Hajredin Pashës shërbeu si hymn në luftrat e tjera që sollën Lidhjen e Prizërenit, të Pejës, kryengrtjet për shpalljen e pamvarësisë së Shqipërisë aq shumë të dëshiruar dhe shumë pritur. Ajo këngë dhe hymn ngjall emocione të mëdha edhe në ditët e sotme.. Stafetën e Cen Lekës në luftrat për çlirim, arsim, e përparim e vazhduan Mustafa Leka, Man Leka, Rrahman Leka, Demir Leka etj. Në gjurmët e Cen Lekës këta patriot u bashkuan në lidhjen e Dibrës, Lëvizja e Plugut (Gropa e Ujkut) luftën për demokratizimin e jetës së vendit, luftën Nacionalçlirimtare. Ata kthyen në realitet ëndrrën e kahershme dhe të shumë pritur të patriotëve Sal Markja, Bajram Markja, Hasan Kaja, Tush Lleshi, Halit Lleshi, Aqif Lleshi, Hamdi Lleshi, Lam Daci, Elez Markja etj, të cilët kanë zënë një vend të veçantë në historinë e popullit tonë patriot e liridashës.Ne gjenerata e sotme jemi krenar dhe përulemi para veprës dhe luftës së të parëve tonë. Me mirenjohje do t'i nderojmë e kujtojmë nga brezi në brez gjithnjë dhe në vazhdim.



Magjia e imazhit për perlat e Rekës së Epërme

(Vijon nga faqja 6)

Jovan Bageri do t'i bëjë thirrje atij, që të kthehej në Shqipëri, për të luftuar me armë në dorë, për lirinë e saj. Vetë Josifi shkruan për këtë: "M'thotë – eja më derdh gjak për shpëtimin e atënis (atdheut), për gjallimin e fisnis".

Nga kopshti i Bagerit vijonte shtegëtimi drejt kullotave të pasura, dhe banorin e vetëm që e takuam, Ademin, na tha se këtu blegtoria ishte ndër nevojat më jetike të kësaj treve, banorët e së cilës mënyrën e jetesës e kishin bazuar vetëm në mbarështimin e blegtorisë. Ademi tha se kanë mbetur në këtë fshat 3-4 familje, por nga ata orthodokse, shtoi ai, nuk kanë mbetur, ata janë shpërngulur gjetiu.

Gjatë vrojtimit të bukurisë idilike sërish lidhemi me Josifin, i cili edhe pse i ri, vendos:

"Mjaft me fyell kam vishllue,
mjaft kullota dhen e dhi,
tani lypën me punue-
për me shëndrit kët Shqypëni".

Sigurisht bisedojmë se kushtet e kanë detyruar Bagerin që të largohet nga këto anë. Ndaj në vitin 1887, shkoi në Sofje të Bullgarisë, vendi që atë kohë kishte tërhequr një numër të konsiderueshëm emigrantësh shqiptarë.

Në verën e vitit 1908, ishte i interesuar të kthehej në vendlindje. Kjo mundësi iu paraqit në gushtin e vitit 1908 kur banorët e Dibrës i bëjnë ftesë atij për t'u bërë mësues i gjuhës shqipe në atë qytet. Ardhja e Josif Bagerit në Rekë pas 20 vjetësh mërgimi tek shumica shkaktoi një gëzim të madh. Poeti kujton : *"...U gëzuen guri dhe druni, po edhe pyjet për njerzinë...të cilët qajshin me lot si breshën në sy...."* Edhe vetë poeti me mall shikonte malet e lëndinat me lule të verdha, ku e kishte kaluar rininë duke kullotur dhentë atyre bjeshkëve. U dëshprua kur vuri re se sa prapa ishin bashkëatdhetarët në dituri. Për këtë arsye filloi të organizonte biseda fshat në fshat për emancipimin kombëtar. Por, propaganda e huaj mundohej ta pengonte. Ai shkruante: *"...ku më pritnin me nder, ku me dru, po un prap po përpiqesha me mbjell vëllazënimin...."*

Edhe në Dibër ishte i pasuksesëshëm. E pengonte despoti sërb Varnava, i cili përmes një ndërmjetësi i ofroi një "thes" me para Josifit me kusht, që ai të bënte propagandën sërbe d.m.th të pranonte se krahina e Dibrës bënte pjesë në tokat e Sërbisë së vjetër. Në këtë rast Josif Bageri ia nguli duart në fyt faqeziut, që guxoi t'i bënte një propozim të tillë, e tërë zemrim i tha: *"Dëgjo këtu, ti senitës (I dërguar) i patriarkanës! Unë jam i vorfun, dhe s'kam as një siguri për ushqimin e fëmijëve, por ndërgjegjen nuk e shes. Nderi i shqiptarit është nder kur punon për kombin, e jo për dhombin...!*

Ademi me kureshtje ndëgjonte për vuajtjet e Bagerit dhe përkjekjet e tij për çështjen kombëtare duke lënë të vrarë në luftë për lirinë e Shqipnisë të katër djemtë por duke hapur edhe gazetën "Drita" e "Shqypeja e Shqypnis"

Ai i botonte ata me shumë mundime dhe sakrifica ashtu si publicistët e tjerë të njohur të Rilindjes sonë, që punuan pa u kursyer, me pasion e me dëshirë të zjarrtë për të përhapur zërin e popullit shqiptar në luftën për fitoren e pavarësisë kombëtare.

Ai gjithmonë shprehej i themi Ademit: *"gjith ata që i duan t'mirën e Shqypenis lipen t'kien letër këmbim me ne!"* Gazetën që e botonte ai e quante *"Levorvere dinamiti"* dhe me të donte ti tregonte *"Halldupit Aziat, se sa para i ban gjaku para trimnis së shqiptarëve.*

Ndërsa për Kongresin e Dibrës më 15 korrik të vitit 1909 tetë ditë përpara, J.Bageri në një shkrim shpreh shqetësimin se kjo mbledhje ishte nxitur nga xhonturqit. Kurse më 1 gusht 1909 në një shkrim tjetër do ti përgjigjej pyetjes "Kush e thiri Kongresin e Dibrës", pasi tregon cilët ishin ata që e organizuan Kongresin, Bageri vazhdon *"po për fat të keqin të zhonervet, terezija anoi më shumë në anën e shqiptarëve, të cilët ma tepër kujtonin për vendin e tynej e jo për botën"*. Dhe kështu kongresi mori një tjetër pozë.

Duroja me Fitimin në fund të bisedës na njoftuan se shoqata e të Burgosurve politik në Dibër të udhëhequr nga Bashkim Mashkulli dhe Komuna Dibër do të ngrejnë në sheshin Skënderbe bustin e Said Najdenit dhe Josif Bagerit. Dhe në ecjen në këmbë teposhtëzës së Korabit mitik u larguam nga Nistrova me konstatimin se Bageri ishte një patriot i flaktë, me këtë kujtim për të u larguam nga Nistrova dhe kopshti i tij, që do ta kujtojmë gjatë.

Atli DEMA

kritikë

Në librin e Fehmi Kaloshit "Kosova, vendorigjina e Skënderbeut", trajtohen dy probleme: Kaloshët e Dibrës së Poshtme në rrethin e Dibrës janë i njëjti fis me Kastriotët dhe Vendorigjina e Kastriotëve dhe e Skënderbeut është Kosova.

Fehmi Kaloshi: Një tezë e re për vendorigjinën e Skënderbeut

Nga: **XHAFER MARTINI**

Libri "Kosova, vendorigjina e Skënderbeut", i autorit Fehmi Kaloshi ka dy-tri vjet që është botuar. Ka libra që *ndricojnë* për një farë kohe, pastaj harrohen; ka të tjerë që, në kohën kur botohen, nuk ngjallin ndonjë interes, por, më vonë, fillojnë dhe imponohen në mënyrë graduale. Ka edhe libra që imponohen qysh kur botohen dhe mbesin vazhdimisht në vemendjen e lexuesve. Libri i Fehmiut bën pjesë në ato libra që nuk është si xixillonjë jetëshkurtër, por një dritë e përhershme, në kuptimin si burim referimi.

Fehmi Kaloshi, në vitin 1957, mbaroi shkollën Pedagogjike të Peshkopisë me rezultate të larta. E emëruan mësues matematike. Punoi në Dibër dhe në Mat deri në vitin 1964, kur u thirr për të kryer shërbimin ushtarak. Pasi kreu shërbimin ushtarak, nuk e pranuan më në arsim, si të papërshtatshëm për të mësuar dhe edukuar brezin e ri. U detyrua të bënte punët më të rënda, si: druvar, vagonist etj. për shumë vite me radhë.Gjatë kësaj kohe, edhe pse mbaroi Institutin "A.Xhuvani" në Tiranë për gjuhë-histori, nuk e ushtroi profesionin. Lufta e klasave, që vinte duke u ashpërsuar, e privoi përfundimisht nga kjo e drejtë elementare, sic është e drejta e punësimit në profesionin përkatës. Megjithëse nuk u mor me histori në mënyrë sistematike dhe profesionale, ai në saj të studimit vetiak, gërmimit nëpër arkiva, gjurmimit të kujtimeve popullore etj., u bë historian autodidakt. Krahas disa artikujve për probleme të historisë në shtypin e ditës, ai shkroi librin me titull: "Kosova, vendorigjina e Skënderbeut", botuar nga "Vatra", më 2006.

Ky libër ka dy burime: veprat historike të botuara për Skënderbeun, si dhe materiale folklorike,arkeologjike, tregime gojore, kujtime, toponime dhe materiale të tjera që i takojnë etnokulturës. Përmenden në të dhjetra emra njerëzish që kanë kontribuar me kujtimet e tyre dhe që Fehmiut i kanë shërbyer në punën e tij. Është libri më i pasur me burime popullore.

Në librin e Fehmi Kaloshit "Kosova, vendorigjina e Skënderbeut", trajtohen dy probleme:

1. Kaloshët e Dibrës së Poshtme në rrethin e Dibrës janë i njëjti fis me Kastriotët;

2. Vendorigjina e Kastriotëve dhe e Skënderbeut është Kosova.

Të ngresh një hipotezë(në fakt këtu janë dy) dhe, ca më shumë, ta vërtetosh atë, sic është përpjekur të bëjë Fehmi Kaloshi, është një kontribut i mirë në shkencë, sidomos kur ke të bësh me figurën e Skënderbeut dhe derën e madhe të Kastriotëve. Je apo nuk je dakord me qëndrim të tillë, nuk ka shumë rëndësi, sidomos kur ke të bësh me probleme madhore të historisë së kombit tonë, për të cilat ka mendime të ndryshme, nganjëherë krejt të kundërta. Rëndësi ka fakti që problemi të ngrihet në bazë të logjikës historike. Unë personalisht, meqë jam autor i një libri për figurën e Skënderbeut ("Optika e Schmitt-it për Skënderbeun", MB, Tiranë 2009), duhet të pohoj që vendin e origjinës së Kastriotëve e Skënderbeut e shikoj në Sinjë të Dibrës së Poshtme dhe askund tjetër, por kjo nuk më bën të mos marr në konsideratë dhe të mos vlerësoj problemet që ka ngritur Fehmi Kaloshi dhe argumentet që sjell për t`i mbështetur.

I. KASTRIOTËT DHE KALOSHËT JANË NJË FIS.

a) Mbiemri Gjini i pari dhe i përbashkët për Kastriotët dhe Kaloshët.

Të ngresh një hipotezë(në fakt këtu janë dy) dhe, ca më shumë, ta vërtetosh atë, sic është përpjekur të bëjë Fehmi Kaloshi, është një kontribut i mirë në shkencë, sidomos kur ke të bësh me figurën e Skënderbeut dhe derën e madhe të Kastriotëve. Je apo nuk je dakord me qëndrim të tillë, nuk ka shumë rëndësi, sidomos kur ke të bësh me probleme madhore të historisë së kombit tonë, për të cilat ka mendime të ndryshme, nganjëherë krejt të kundërta. Rëndësi ka fakti që problemi të ngrihet në bazë të logjikës historike.

Autori Fehemi Kaloshi, qysh në faqen 11 të librit të tij pohon në mënyrë të prerë: "…Kaloshët e Sinjës në mikrokrahinën e Dibrës së Poshtme, janë vetë gjeneza e Familjes së Madhe Princërore të Kastriotëve, janë vetë Kastriotët". Për të bërë këtë pohim ai sjell si argument faktin që Kastriotët më heret kanë pasur mbiemrin Gjini. Ky mbiemër ekziston edhe sot e kësaj dite në zonën e Hasit të Gjakovës, ku autori shikon vendin e origjinës së Kastriotëve. Gjini, sipas autorit, është trajta e emrit Gjon. Autori i mëshon shumë këtij problemi duke i kushtuar disa faqe të monografisë së tij. Kastriotët, kur u shpërngulën nga Hasi dhe erdhën në Sinjë, e ruajtën mbiemrin e parë Gjini. Ky pohim mbështetet shumë me toponomastikën e krahinës. Autori jep dhjetra emra vendesh, objektesh etj. që janë prona të Gjinit, si Ara e Gjnit, Kroi i Gjnit, Pusi i Gjnit etj., etj.

Pastaj në monografi tregohet se si u bë procesi i islamizimit të njerëzve dhe të emrave të tyre. Kastriotët, si dihet nga historia, ikën në Krujë dhe në vendet e tjera. Që nga koha e Skënderbeut nuk ka Kastriotë në Sinjë. Historiani Kristo Frashëri, në punimin e tij "Nga ishin Kastriotët", shkruan : " Kastriotët kanë qenë të paktën qysh në shekullin XIV banorë të Cidhnës në përgjithësi dhe të Sinës ne vecanti, derisa aty në shekullin XVII, gjurmët e tyre në këtë trevë humbasin përfundimisht." Por F. Kaloshi thotë se jo të gjithë Kastriotët morën rrugën për në vendbanime të reja. Një pjesë e tyre mbeti në Sinjë. Kastriotët e mbetur në Sinjë morën mbiemrin e ri Kalosh. Kalosh vjen nga fjala *kalorës*. Kalorësia ishte ajka e ushtrisë së Skënderbeut. Nuk kishte se si të gjendej mbiemër më i përshtatshëm për Kastriotët e mbetur në Sinjë. Në përforcim të këtij mendimi autori thotë se "Kastriotët dhe Kaloshët nuk janë dy fise, por janë një fis i vetëm, janë i njëjti fis, përfaqësojnë të njejtin gen trashëgimi, janë vetë gjeneza: Gjini i Kastriotëve." Autori ka arritur në këtë përfundim duke u mbështetur kryesisht në tregimet popullore, kujtimet e të parëve të tij, gojëdhënat, toponimet etj. Hide Kaloshi, nëna e autorit dhe bija e Elez Isufit, në lidhje me gjakun e përbashkët kujton : " Sikur e kam nigjue nga baba, Ibrahim Kaloshi, që tregonte sipas të thënave të gjyshërve, kastragjyshërve, fisi i Kaloshëve është fis e gjak me Skënderbeun. Por ne, Kaloshët, nuk mund ta bëjmë fjalë tashti, se mileti do na e marrë për mendje të madhe dhe do t`I duket se po kërkojmë dicka që nuk na takon. Por, or bir, këtë që po të them, ta ruajsh si amanet të shenjtë, se ndoshta vjen një ditë dhe e vërteta del sheshit." Me këtë libër Fehmi Kaloshi sikur con në vend edhe dëshirën dhe amanetin e nënës, duke mbrojtur tezën se Kastriot e Kalosh janë një, një fis, një gjak. Sa e sa herë vëllezërit të një barku kanë mbiemra të ndryshëm. Kjo është një dukuri e njohur në traditën popullore.


Një tjetër shembull: " Plaku 90-vjecar Sadik Kaloshi dhe 75 vjecari Rexhep Kaloshi, që të dy nga qyteti i Krujës, vec e vec, i pari në vitin 1956, dhe i dyti më 1983, kanë treguar të njejtën gjë: "Kemi qenë tre vëllazën. Njëri vëlla mbeti në Sinjë. Njëri shkoi në Tetovë ku mori mbiemrin Deralla. Kur vdiq Skenderbeu, njëri prej fisit të Skënderbeut, mbeti në Krujë. Nga ky person kanë rrjedhur Kaloshët e Krujës. Kaloshët e Sinjës, Derallët e Tetovës, Kaloshët e Krujës janë fisi i Skënderbeut. Të parin e fisit tonë e kanë quajtur Gjin. Ne jemi fisi i Gjinit, gjaku i Gjinit" Në këtë pohim të F. Kaloshit, ndonëse nuk ka mbështetje me anë të dokumentave, por vetëm me thënie të njerëzve të ndryshëm, ka, megjithatë një logjikë historike. Natyrshëm lind pyetja: si humbi mbiemri Kastrioti? Mos vallë të gjithë këta Kastriotë u zhdukën? Skënderbeu nuk ka qenë i vetëm. Fisi i tij ka qenë i madh. Ku shkuan këta? Emigruan? Është e pamundur të kenë emigruar të gjithë, një shenjë do ta kenë lënë. Emigrim të detyruar nga frika e turqve kishte gruaja e Skënderbeut e djali i saj, dhe ndonjë i afërm tjetër, Kastriotët në masë nuk kishin pse ta bënin një gjë të tillë. Megjithatë, emigrimi ka ndodhur vonë, pas vdekjes së Skënderbeut. Ku ishin Kastriotët kur Skënderbeu ishte gjallë? Prandaj ndërrimi i mbiemrit nga Kastriot në Kalosh nuk ka përse të mos besohet.

b) *Lëvizja e Kastriotëve dhe Kaloshëve në të njejtën kohë dhe në të njejta vende*

Edhe lëvizja e njëjtë e Kaloshëve dhe Kastriotëve në të njejtën kohë dhe në të njejta vende, nuk është një rastësi. Edhe ajo hedh dritë mbi atë që Kaloshët dhe Kastriotët janë një fis.Kështu, si shembull, ata lëvizën bashkë në Prishtinë, në Gjinaj të Krumës, në Has, në Kastri të Mirditës, në Sinjë të Dibrës së Poshtme, në Kastriot të Dibrës së Poshtme, në Krujë, në Pollog deri ne Itali..

c) *Pronat e Kastriotëve zotërohen nga Kaloshët*

Kudo ku ka pasur prona të Kastriotëve, që dëshmohen nga toponimet e shumta, sot ato janë të Kaloshëve. Kjo nuk mund të ketë tjetër domethenie vecse Kaloshët e Kastriotët ishin vëllezër të një gjaku, dhe, në bazë të kanunit, cdo pronë kalon tek vëllezërit e një gjaku, kur njëri prej vëllezërve shkretet ose largohet në një vendbanim tjetër. Kështu, si shembull, *Vreshti në Gardh*, pronë e Kastriotëve në Sinjë sot është pronë e Kaloshëve, ku është ngritur lagjija e tyre; *kisha e Kastriotëve* ka qenë në vendin ku sot është ngritur Muzeu i Skënderbeut, pronë e Kaloshëve; *Lagjja e Kastriotëve* sot është Lagjja e Kaloshëve etj., etj. Autori radhit me dhjetra toponime që vërtetojnë se pronat e Kastriotëve sot i kanë Kaloshët. Kjo është dëshmia më e sigurtë e vëllezërve të një gjaku.



d) *Në troje të Kaloshëve janë gjetur objekte të Kastriotëve dhe Skënderbeut.*


Në shtëpitë dhe pronat e Kaloshëve, ndonëse jo me ekspedita kërkimore të qëllimshme, por nga rastësi, janë gjetur shumë objekte që u përkisnin familjes së Kastriotëve dhe Skënderbeut. Në bahcen e Selim Kaloshit në Sinjë, në pranverë të vitit 1982, është gjetur një *bust prej bronzi i Skënderbeut*, 10-15 centimetra i lartë, objekt i një rëndësie të vecantë që e pasuroi më tej Muzenë e Skënderbeut në Sinjë, i cili sot nuk ekziston, pasi u vodh dhe u shkatërrua në rebelimin e armatosur të vitit 1997. Tjetër objekt është edhe një *pllakë metalike*, gjetur në arat e Kaloshëve, pikërisht në Kodrën e Cardakut, sot pronë e Kaloshëve. Në këtë pllakë është skalitur flamuri i Kastriotëve me shqiponjën me dy krerë dhe me yllin me gjashtë cepa. Një tjetër *pllakë metalike*, në formën vezake, ku është shkruar : "Gjergj Kastrioti Skënderbeu ka lindur në katundin Sinjë të Dibrës" ndodhet e ekspozuar në Muzeun Historik të Skënderbeut në Krujë. *Unaza e Skënderbeut* është gjetur në katundin Arras, afër Sinjës. Hide Kaloshi tregon për këtë objekt: "Plaku Rustem Paci, nga katundi Arras, më ka treguar se Skënderbeu e kishte harruar unazën te një fis i Marcenve. Skënderbeu ishte sëmur me ethe të rënda. Ishte ulur në krye të vendit, pranë oxhakut, dhe po ngrohej në zjarr. Nga të nxehti, nuk e kishte duruar dot unazën dhe e kishte hequr, duke e vendosur në rrasën e oxhakut. U dha lajmi se "Hipi turku" dhe Skënderbeu nga nxitimi e harroi unazën…"

II. KASTRIOTËT ISHIN ME ORIGJINË NGA HASI I GJAKOVËS NË KOSOVË

Për të mbështetur mendimin që Kastriotët ishin nga Hasi i Gjakovës së Kosovës autori i këtij libri bën shumë përpjekje që në tërësinë e tyre janë të lavdërueshme, por baza dokumentare është ajo që ka qenë, me cka duhet kuptuar se referencat janë nga autorë të njohur që kanë shkruar për Skënderbeun. Natyrisht, që nuk do të prisnim ndonjë zbulim sensasional, por, gjithsesi, një mbështetje e re dokumentare do të ishte e dëshirueshme. Por mënyra e arsyetimit të F.Kaloshit duhet marrë në konsideratë, ndonëse ajo ecën në linjën e përqasjes së dokumenteve të njohura. Ai shkruan : "Kastriotët me origjinë krahinore nga Hasi i Gjakovës, në Kosovë, kishin zbritur nga Kastri i Mirditës në Sinjë, Cidhën të Dibrës së Poshtme para vitit 1368….rreth vitit 1383, sipas Nolit, futën nën zotërimin e tyre Sinjën dhe Gardhin e Poshtëm.

(Vijon në faqen 16)

Seriali i persekucionit filloi me 30 tetor 1943 për të mos u ndalë kurrë për 50 vite radhazi. Nga 1943 deri më 1991, çdo 1.8 vjet një i pushkatuar dhe çdo 1.8 vjet një i dënuar politik.



Të pushkatuarit dhe të dënuarit në krahinën e Çidhnës

Nga: **HAKI PERNEZHA**

Sikur të mos mjaftonte djegia e fs hatrave të Çidhnës 2 herë nga serbët (1913 dhe 1918), një pjesë e Çidhnës u dogj e u shkretua nga partizanët (!!!) në korrik të vitit 1944, dhe me pas për 50 vjet popullsia e këtyre fshatrave (F.Alie, Laçes, Blliçe e Rrenx), iu nënshtruan një përndjekje e lufte politike të pashoqe në historinë e kombit tonë, rezultatet e së cilës ishin:

- u vranë e u pushkatuan 74 veta

- u arrestuan e u dënuan 76 veta (njëri është djegë i gjallë në zjarr)

- jane kryer gjithsej 595 vite burg. Një në çdo 100 banorë të krahinës është i pushkatuar ose i dënuar me burg politik.

Pse gjithë kjo masakër në Çidhën? Çfarë kishin bërë këta njerëz që u desht të paguajnë aq shtrejtë, me jetën e tyre. Ndoshta ata nuk qenë dakord e nuk u pajtuan me sistemin që po vendosej, po a mjafton ky "faj" për tia marrë jetën një njeriu?...

Seriali i persekucionit filloi me 30 tetor 1943 për të mos u ndalë kurrë për 50 vite radhazi. Nga 1943 deri më 1991, çdo 1.8 vjet një i pushkatuar dhe çdo 1.8 vjet një i dënuar politik. Arrestimet e bujshme, zhillimi i gjyqeve dhe pushkatimet e kryera me banorët e zonës, duket sikur ishin të planifikuara, pasi nuk ka vit kalendarik ('43-'91) që të mos ketë pushkatim, arrestim, gjyq "shembullor" apo lirim nga burgu (kjo pas viteve 1980). Sepse edhe lirimi nga burgu i këtyre njerëzve shndërrohej në "spektakel" politik, që... çidhnakët të rrinin urtë.

Më 30 tetor 1943 u vra Selman Lata.

Më 23 dhjetor 1943 u vranë: Haziz Alia, Fil Skepi, Mudë Coli, Ramadan Dika,Han Tota, Hysen Dika, Arif Pergjegji, Sali Noka.

Me 6 maj 1944 u vra Halit Leshi.

Me 1 qershor 1944 u vra Hajdar Spata e Haziz Kaloshi.

Me 25 qershor 1944 u vra Sabri H. Laci.

Me 8 korrik 1944 u vrane: Tafë Kacani,Fezë Spata,Sef Alia, Shaqir Buci, Qazim Tërshana. Shaban Kukeli.Tahir Alia, Dinë Shehu,Shaban Alia, Ibrahim Rusi.

Më 18 korrik 1944 u vra Miftar Kaloshi.

Më 27 korrik 1944 u vranë: Isuf Loka, Haziz Tosku, Ahmet Drizi, Fali Drizi, Halim Pashnjari, Jahe Murraku, Selim Drizi, Ismail Pashnjari, Ibrahim Murraku(e hodhen te gjalle ne zjarr).

Më 5 gusht 1944 u vra Hajredin Spata (u plagos edhe Adem Bushi).

Më 25 gusht 1944 u vra Rexhep Bodi.

Më 27 gusht 1944 u vra Nazif Raska.

Më 2 nentor 1944 u vra Sherif Kola.

Më 12 nentor 1944 u vrane: Dervish Lusha, Isuf Bajraktari.

Më 5 dhjetor 1944 u vra Sefedin Noka.

Më 16 dhjetor 1944 u vrane: Maliq Alia, Halim Gjoni.

Më 18 dhjetor 1944 u vrane Zenel Buci,Abdulla Alia.

Më 23 dhjetor 1944 u vrane Halil Alia,Xhetan Gjoni, Selman Kukeli.

Më 30 mars 1945 u pushkatua Hamit Kukeli.

Më 6 prill 1945 u arrestua Hasan Prifti.

Më 9 maj 1945 u pushkatua Mersim Hasi.

Më 1 korrik 1945 arrestohet Qazim Noka.

Më 23 korrik 1945 u pushkatua Halit Prifti.

Më 31 gusht 1945 u pushkatua Xhafer Kaloshi.

Më 25 shkurt 1946 u pushkatua Xhafer Pana, Tofik Lusha, Sefedin Lusha.

Më 5 prill 1946 u arrestua Shaban Hata.

Më 9 prill 1946 u pushkatua Qazim Kaloshi.

Më 9 prill 1946 u arrestua Medi Kaloshi.

Më 15 prill 1946 u arrestua Halim Kaloshi.

Më 16 qershor 1946 u pushkatua Rustem Bitri.

Me 17 qershor 1946 u pushkatua Adem Bitri.

Më 10 qershor 1946 u arrestua Abaz Kaloshi.

Me 23 qershor 1946 u arrestua Halit Gjini.

Më 26 qershor 1946 u arrestua Sali Gjini.

Më 27 qershor 1946 u arrestua Haxhi Skepi .

Më 15 korrik 1946 u arrestua Ismail Daci.

Më 17 korrik 1946 u arrestua Ilmi Manerkolli.

Më 2 gusht 1946 u pushkatua Bajram Cakrri.

Më 4 gusht 1946 u arrestua Shaban Kaloshi.

Më 12 gusht 1946 u arrestua Emin Kaloshi.

Më 13 gusht 1946 u arrestua Shaqir Kaloshi.

Me 7 shtator 1946 u pushkatua Faredin Jahja.

Më 27 shtator 1946 u arrestua Ramadan Pula.

Më 30 shtator 1946 u arrestua Ibrahim Krrashi.

Më 10 nentor 1946 u pushkatua Maliq Sava.

Më 6 dhjetor 1946 u pushkatua Bajram Vlesha.

Më 12 dhjetor 1946 u pushkatua Elez Kaloshi.

Më 13 janar 1947 u pushkatua Sulë Kukeli.

Më 28 shkurt 1947 u arrestua Lam Skepi.

Më 3 mars 1947 u arrestua Haziz Raska.

Më 3 qershor 1947 u arrestua Daut Koltraka.

Më 16 korrik 1947 u arrestua Sabri Doci.

Më 28 tetor 1947 u arrestua Sali Suli.

Më 20 dhjetor 1947 u pushkatua Xhemal Kaloshi.

Më 31 dhjetor 1947 u arrestua Ramadan Kaloshi.

Më 13 janar 1948 u pushkatua Zenel Lika.

Më 31 maj 1948 vdiq ne burg Sali Suli.

Më 30 gusht 1948 u pushkatua Sulë Kacani. Po këtë vit u arratisen Shaqir Derti, Hamit Derti dhe me vonë Rexhep, Selim e Mexhit Leka.

Më 25 shkurt 1949 vdiq ne burg Ramadan Kaloshi.

Më 24 prill 1949 u pushkatua Sefedin Lusha.

Me 25 shkurt 1950 u arrestua Sulltane Lusha.

Me 25 maj 1950 u vra Demir Lusha.

Më 21 qershor 1950 u arrestuan: Sabedin e Rasim Kaloshi.

Më 7 shtator 1950 u arrestuan: Met Cuni, Sabri e Sulë Derti dhe Fezë Daci.

Më 27 shtator 1950 u pushkatua Selman Rusi.

Ne maj 1951 u vra Ibrahim Kojnozi,u plagos Rexhep Leka.

Më 13 qershor 1951 u arrestua Osman Kovaci, Isuf Lusha.

Më 8 dhjetor 1951 vdiq ne burg Haxhi Noka.

Më 24 qershor 1951 u arrestua Dinë Bitri.

Në vitin 1953 arratiset: Adem Bushi.

Më 1958 vritet ne Beograd Hasan Spata.

Më 24 prill 1958 u arrestua Musa Rusi.

Më 4 qershor 1958 u arrestua Shefki Spata.

Më 7 qershor 1958 u arrestua Hajredin Alia.

Maj 1958 arratisen: Lam, Haxhi, Qani Skepi dhe familja e Halil Alisë. Iku edhe Ramadan Tota.

Më 16 mars 1961 vdiq ne burg Halil Lusha.

Me 15 gusht 1961 u vra Hasan Xh. Spata.

Më 13 shtator 1963 u arrestua Bajram Bitri.

Me 20 tetor 1965 arratisen: Nazmi Dauti, Haxhi Pula, Xhemal Spata,Muharrem Spata,Qamil Spata, Dalip Sapat.

Më 20 tetor 1965 u vra Haxhi Pula.

Me 20 tetor 1965 u arrestua Xhemal Spata.

Me 23 tetor 1965 u arrestua Xhelil Ferra.

Me 23 tetor 1965 u arrestua Rasim Dauti.

Më 22 maj 1966 u arrestua Fetah Hysa.

Me 3 qershor 1966 u arrestua Xhetan Rusi.

Më 7 janar 1969 u arrestua Staf Lusha.

Më 18 janar 1969 u arrestua Gani Noka.

Më 6 gusht 1969 u arrestua Sulbie Gjini (Spata).

Më 27 nentor 1970 u arrestua Sakip Kaloshi.

Më 10 qershor 1971 u arrestua Hakik Kuta.

Më 18 qershor 1971 u arrestua Dalip Hasi.

Më 12 nentor 1971 u arrestua Seit Gjoni.

Me 9 dhjetor 1971 u arrestua Elez Marku.

Me 10 shkurt 1972 u arrestua Ilmi Kurti.

Me 29 mars 1972 u arrestua: Halit Marku, Ramadan Kurti.

Më 18 gusht 1972 u arrestua Shaban Spata.

Më 29 mars 1973 u pushkatua Shaqir Noka.

Me 20 prill 1973 u pushkatua Selim Bitri.

Më 2 shkurt 1974 u arrestua Seit Nezha.

Me 25 prill 1974 u arrestua Ilmi Sapata.

Më 25 janar 1975 u arrestua Hasan Tota.

Me 25 prill 1975 u arrestua Han Tota.

Më 27 prill 1975 u arrestua Haziz Noka.

Më 8 dhjetor 1975 u arrestua Xhemal Tota.

Me 12 shtator 1976 u arrestua Rasim Dauti.

Me 28 shtator 1977 u arrestua Xhelil Ferra.

Me 24 gusht 1978 u arrestua Mersim Lusha.

Me 7 shtator 1978 u arrestua Ramiz Sapta.

Me 11 shtator 1978 u arrestua Rexhep Kacani.

Me 10 tetor 1978 u arrestua Kade Marku.

Me 10 gusht 1980 u arrestua Shefki Sapat.

Më 12 gusht 1980 u arrestua Nazmi Kukeli.

Në këtë paraqitje nuk po shënojmë datat dhe lirimin nga burgu e të arrestuarve të sipërshënuar, i cili ka ndodhë në 10 vjeteshin e fundit (1980-1991). Gjithë kjo katrahure është zhvilluar "në zbatim të porosive të çmuara" të PPSH, nën kujdesin e Sigurimit të Shtetit, me zellin e hetuesve e prokurorëve të asaj kohe, të cilët asnjëherë nuk u penduan e nuk kërkuan ndjese për asnjë çast, edhe sot e kësaj dite.

Tregime alegorike dibrane

(Vijon nga faqja 10)

Këtë ta hani e bëftë mirë, se e keni hallall – u tha plaku dhe shtroi darkën. Lidhur me këtë një fjalë e urtë popullore thotë: Miqtë e babës nderoi, kurse miqtë e tu provoi.

- Një burrë plak, i përmendur për fjalët e tija të mençura, thirret në një kuvend. Ky plaku ishte i sëmurë dhe mendoi të çonte në atë kuvend të birin. Para se i biri të nisej për në kuvend i tha: Do të shkon në kuvendin e burrave, por do të marrësh me vete tri gjëra: Një metër, një kandar dhe një thikë me dy presa. Po ç'ti dua këto or baba – i tha djali? Po or bir, ta tregoj unë: Me metrin mate mirë vendin ku do të ulesh. Me kandarin peshoi mirë fjalët që do të thuash. Me thikën me dy presa, para se t'ia ngulësh të tjerëve, ngulja njëherë vetes tënde d.m.th. debatet të jenë konstruktive, të hapura, të sinqerta, me kuptime, pa qëllime e pa e vrarë atë tjetrin në ndërgjegje, sepse njeriu rron për një nder e për dinjitetin e tij si atdhetarë shqiptarë.

- Një baba i thotë djalit të tij: Biri im. Ti po hyn përmes derës së përtacisë në jetë. Përtacia është si ajo makina e petëzimit, po të kapi të shtyp. Rropatu e lodhu o dembel dhe fitoje lekun vetëm me punë. Të jesh dembel e të rrosh në kurriz të shoqërisë, do të thotë të jesh i padobishëm për veten tënde dhe për shoqërinë. Kjo të shpie drejt mjerimit. Ndaj të lutem më dëgjo mua: mos ndiq këtë rrugë. Përtacia të meson për të zezën tënde. Më e keqja është vedhja. Ec tani e veri gishtin kokës për sa të thashë. Këto ishin mësimet e babait për të birin. Të gjithë ata që nuk i kanë dëgjuar mësimet dhe këshillat e prindërve të tyre, herët ose vonë kanë thyer qafën.

Të tilla tregime alegorike dibrane ka me qindra e mijëra. Këto, siç e theksuam janë trashëguar në breza dhe përdoren edhe sot e kësaj dite. Ndaj me të drejtë këto janë quajtur "Shkolla e Dibrës".

Përgatiti: Ymer Stojku

requiem

Agron Sela: "Pata mundësi ta njoh si mik dhe luftëtar të çështjes kombëtare, Ai ishte njeriu që ua zbardhi faqen Dumanëve dhe ne të gjithëve."

Mirë se erdhe Iljaz Pashë Qoku!

(Vijon nga faqja 9)

Më tej ai tha se "Në ngjarjet madhore për mbrojtjen e indentitetit kombëtar, për mbrojtjen e trojeve dhe të vlerave kombëtare, dibranët u përfaqësuan me bijt e tyre më të mirë, personalitete mbarë kombëtare, si ; Gjergj Kastrioti - Skënderbeu, Iljaz Pashë Dibra, Selim Rusi, Sait Najdeni, Vehbi Dibra, Nikol Kaçorri, Sheh Sula, Hoxhë Muglica, Sheriff Lëngu, Isuf Karhasani, Elez Isufi, etj, që organizuan kuvende, udhëhoqën kryengritje, ruajtën vetëqeverim në shërbim të çështjes kombëtare për emancipim, demokratizim jo vetëm të Dibrës, por dhe mbarë trevave shqiptare. Disa nga këto personalitet dibranë mbajtën poste drejtuese shumë të rëndësishme në drejtimin dhe qeverisjen e trevave shqiptare" ka konkluduar në referatin e tij drejtori i Muzeut të qytetit të Peshkopisë, Moisi Kamberi,

Rreth origjinës dhe vlerave të atdhetarit të shquar dibran Iljaz Pashë Qoku- Dibra, foli historiani Nebi Xhembulla.

"Në historinë e fshatit Klobçisht, ku lindi e rritë ai, nuk mund të jetë tjetër kush veçse Iljaz Pashë Dibra (i thirrur edhe Iljaz Qoku). Ai ka qenë personalitet i shquar i Lidhjes Shqiptare të Prizrenit, ai që lindi në këtë fshat karakteristik të Dibrës. Iljaz Pashë Dibra (Qoku), u bë i njohur me pjesëmarrjen e tij me 1844 në luftën e Gjoricës (Dibër) kundër Hajredin Pashës, i cili kërkonte të zbatonte reformat e tanzimatit në verilindje të Shqipërisë .

Më 1861, Iljaz Pashë Dibra (Qoku) udhëhoqi forcat Dibrane kundër përpjekjeve malazeze për të shtirë në dorë viset e Shkodrës . Ai është një ndër themeltarët e Lidhjes Shqiptare të Prizrenit. Kryesoi më 10 qershor 1878 Kuvendin e Përgjithshëm që çoi në formim të Lidhjes së Prizerenit, dhe u zgjodh kryetar i saj.

Kryesoi Kuvendin e Parë të Dibrës më 1 nëntor 1878. Në përfundim të punimeve Kuvendi i Dibrës i kryesuar nga Iljaz Qoku, miratoi një program të përbërë prej pesë kërkesash, mes tyre formimi i Vilajetit të Shqipërisë, pajisja e tij me nëpunës shqiptarë, zhvillimi i arsimit në gjuhën shqipe, zbatimi i reformave nga Kuvendi i Madh, përdorimi i një pjese të madhe të buxhetit për përparimin e arsimit dhe për ndërtime shkollore.

Nga programi i Komitetit të Stambollit nuk u përfshinë haptas në rezolutë vetëm parimet demokratike të strukturës shtetërore të Vilajetit të Shqipërisë. Vendin e tyre këtu e kishte zënë e drejta që do të kishte Kuvendi i Madh për të zbatuar "reforma të dobishme për shtetin dhe për kombin". Më në fund në rezolutë thuhej se këto kërkesa do t'i paraqiteshin brenda një muaji në emër të të gjithë popullit shqiptar, Portës së Lartë, me anë të një delegacioni të përbërë nga personalitete të shquara

Më 1861, Iljaz Pashë Dibra (Qoku) udhëhoqi forcat Dibrane kundër përpjekjeve malazeze për të shtirë në dorë viset e Shkodrës . Ai është një ndër themeltarët e Lidhjes Shqiptare të Prizrenit. Kryesoi më 10 qershor 1878 Kuvendin e Përgjithshëm që çoi në formim të Lidhjes së Prizerenit dhe u zgjodh kryetar i saj... Përurimi i bustit të Iljaz Pashë Dibrës është një përpjekje për t'a vendosur atë në përmasat e tij reale...

të Shqipërisë.

Anëtarët e delegacionit, para se të vinin në Stamboll, duhej të merrnin pëlqimin, me mandat të shkruar, nga të gjitha kazatë dhe sanxhakët shqiptarë. "Shqipëria, - thuhej në fund të rezolutës, - do të rezistojë duke qenë e lidhur dhe e bashkuar si një trup i vetëm, derisa të arrihet plotësimi i kërkesave të lartpërmendura". Sipas marrëveshjes që u arrit në Dibër, delegacioni që do ta paraqiste dhe do ta mbronte rezolutën para Portës së Lartë do të përbëhej nga 14 veta, midis të cilëve ishin Iljaz Pashë Dibra (Qoku), Sheh Mustafa Tetova, Hasan Pashë Prizreni, Mustafa Pashë Vlora, Abedin Bej Dino, Mehmet Ali Vrioni, Sabri Gjirokastra, Mihal Kristo, Abdyl Frashëri etj.

Ndërsa, detyrën për të nxjerrë mandatet, me të cilat miratohej nga përfaqësuesit e kazave e të sanxhakëve shqiptarë rezoluta dhe mandatet e përbërjes së delegacionit, e morën përsipër Iljaz Pashë Dibra (Qoku) për krahinat veriore dhe Abdyl Frashëri për krahinat jugore. Në veri mandatet e miratimit të rezolutës dhe të pjesëtarëve të delegacionit Iljaz Pashë Dibra (Qoku) i përfundoi aty nga mesi i janarit 1879. Ndërsa Abdyl Frashëri një muaj më parë. Rezoluta iu paraqit Portës së Lartë (TURQISE)në fillim të shkurtit 1879.

Iljaz Pashë Dibra (Qoku), ishte ai që e kryesoi edhe Kuvendin e dytë të Dibres (20 Tetor1880), në të cilin u paraqit si udhëheqës i rrymës së moderuar .

Në fund të fjalës së tij, historiani i njohur dibran Nebi Xhembulla, tha se përurimi sot, i bustit të Iljaz Pashë Dibrës, është një përpjekje për t'a vendosur atë në përmasat e tij reale, por, që nuk u vlerësuan në shkallën që meritonte për arsye klasore siç thuhej nga sistemi komunist i kohës.



Myftiu i Peshkopisë, Muhamed Caushi, Ibrahim Egriu dhe sponsori i bustit të Pashë Qokut, Ylber Pilku me bashkëshorten.



Gjeneral Gëzim Ostreni: "Gafur Dumani, me angazhimin si mësimdhënës, si afarist dhe pjesëmarrës në luftën e UCK-së, la gjurmë të paharrueshme në krijimin dhe formësimin e personalitetit të tij."

Nderim për Gafurr Dumanin

DIBER E MADHE : Një nga veprimtarët, dhe aktivistët më të dalluar të çështjes kombëtare në Dibër të Madhe, Gafurr Dumani, vdiq në moshën 59 vjeçare. Ai prej vitesh po mjekohej nga një sëmundje e pashëreushme.

Gafurr Dumani u dallua në Dibër si mësues, si afaristë i suksesshëm dhe si pronar e editor i të parit dhe të vetmit televizion në gjuhën shqipe në Dibër të Madhe, TV AlfaD. Por, ishin aktivitetet e tij gjatë luftës në Maqedoni, përfshirja e tij në radhët e Ushtrisë Çlirimtare Kombëtare, që patën efektin më të madh, aq sa ai u bë një emër edhe më i dashur e i respektuar për dibranët.

Dashuria e tij për atdheun ishte e kahmotshme ajo ishte pjesë e origjinës së familjes së tij - njëra prej familjeve patriote në Dibër. Gjatë gjithë jetës, Dumani ishte i angazhuar në shprehjen e pakënaqësisë politike ndaj sundimit sllavo komunist në ish-Jugosllavi. Si kundërshtar i i përbetuar i regjimit sllav, në trojet etnike, ai mori pjesë aktive në luftën për çlirimin e Kosovës, dhe rroku armët e veshi uniformën ushtarake në luftën e shqiptarëve në Maqedoni, gjatë vitit 2001, duke u bërë pjesëtar i radhëve të Brigadës 111-të, të UÇK-ës.

Në vizitën e fundit në Dibër të Madhe, unë pata rastin t'a takojë në shtëpinë e tij. Ai ishte i dashur, i afërt dhe i ngrohtë, në bisedë, qysh në takim të parë. Ai ishte fjalë pak, fjalë ëmbël dhe mjat kurajoz, megjithëse sëmundja po e merrte me vete. Dhe nuk më ra rasti dhe nuk pashë as edhe një nga ata që do të vinin në dyshim rëndësinë e asaj çfarë ai kishte për çështjen shqiptare, Dibrën dhe dibranët. Kudo dëgjoje e fjalët më të mira.

* * *

Një nga televizionet lokale, TV2, gazetari i saj Atli Dema, raportoj se nga një sëmundje e rëndë dhe e pashërueshme në moshën 59 vjeçare, pranë familjes së tij ndërroi jetë në Dibër të Madhe, Gafurr Dumani. Gjatë gjithë jetës së tij - Ai iu përkushtua , familjes, kombit dhe Dibrës që e deshi aq shumë dhe çështjes kombëtare.

Në fillim ai punojë si mësimdhënës e afaristë, mëpastaj ai u dallua si drejtor i televizionit të parë dhe të vetëm privat në Dibër të Madhe TV-AlfaD. Televizion ky që ishte e vetmja dritare ku qytetarët e Dibrës mund të shikonin të vërtetën, se çfarë po ndodhte në qarkun e tyre e për rreth saj.

Ky television do të mbahet mend gjatë në mendjen e sytë e dibranëve, për rolin që luajti ai gjatë zhvillimeve më të fundit në Maqedoni, konfliktin e vitit 2001. Ai gjatë kësaj kohe zhduku çensurën dhe u bë televizion pjesëmarrës në luftën e shqiptarëve në Maqedoni. Aq sa ky televizion la gjurmë edhe në krijim e personalitetit të tij.

Vdekja e tij është një humbje e madhe si për familjen, qytetarët dibranë, por edhe për ish pjestarët e UÇK-ës, me të cilët ai pati lidhje të mira, të cilat i ruajte në mënyrë shumë korrekte deri ditën që mbylli sytë. Duke i përballuar edhe tëgjitha sfidat e jetës dhe punuar e menduar për një të ardhme më të mirë.

Për këtë arsye edhe gjatë lamtumirës së fundit, komandati i UÇK-ës, gjeneral Gëzim Ostreni, gjatë leximit të letrës së lamtumirës, u shpreh se "Gafurr Dumanit, asnjëherë nuk i mungonte guximi - gjithmon ishte optimist , dhe prandaj iu ngjitë rradhëve të Brigadës 111 të UÇK-ës, për të realizuar atë që ai ndjente në shpirtë dhe e deshironte për popullin e vetë."

Ostreni, më tej vijojë dukë thënë se sot me keqardhje pranuam lajmin e vdekjes së mikut, shokut tonë Gafur Dumani, i cili me angazhimin si mësimdhëns, pastaj si afarist, dhe pjesmarës në luftën e UCK-së la gjurmë të paharueshme në krijimin dhe formësimin e personalitetit të tij. Ai tha se vdekja e tij është një humbje e madhe si për familjen shoqerinë po ashtu edhe për ne pjestarët e UCK-së që gjithmonë diti të jetë afër dhe me krenari të përballojmë sfidat për krijimin e një të ardhme më të mirë. Gjeneral Ostreni, i emocionuar, nëpërmjet mesazhit të lamtumirës tha se" Ty Gafur! nuk të mungoi asnjëherë guximi. Gjithmonë, ishe optimist, prandaj edhe ju bashkangjite rradhëve të brigadës 111 të UCK-së për të realizuar atë që ti e ndjenje në shpirt, dhe e dëshironje për popullin tënd.

Ty të humbëm në kohën që na duheshe, tha Osterni, edhe mëtutje për të aritur deri në fund qëllimet e luftës dhe të flijimit. Por, sigurisht këtë amanet shokët e tu dhe gjeneratat që vijnë do të vazhdojnë ta realizojnë deri në fund.

Letra dhe mesazhe të shumta ngushëllmi ia janë drejtuar familjes dhe anëtarëve të saj - nëpërmjet faqes së internetit në virtualin dibran, Dibra .org. Mes tyre ka lënë shnimin e tij, ngushëllues dhe veprimtari i dalluar i komunitetit Agron Sela, duke nënvizuar se "Pata mundësi ta njoh si mik dhe luftëtar të çështjes kombëtare, Ai ishte njeriu që ua zbardhi faqen Dumanëve dhe ne të gjithëve."

Varrimi i të ndjerit me të gjitha nderimet fetare dhe qytetare u bë në qytetin e tij të lindjes me pjesmarrjen e gjith qytetarëve të Dibrës, por edhe të ardhur nga zonat për rreth në varrezat publike në Dibër të Madhe.

Beqir Sina

Rruga Arbërit nr. 39
botime

...Ajo që nuk zgjidhet me asnjë ligj, me asnjë dekret, edhe me hyrjen e Shqipërisë në Bashkimin Evropian, është GJUHA E NËNËS, Gjuha Shqipe. Shqiptarët po humbin identitetin gjuhësor.

Botohet libri "Shkolla Shqiptare e Athinës"

...Shoqatat, shoqëritë, grupimet, të majtë, të djathtë, të qendrës, të tokës, të qiellit...flasin për kartat, lejet e qëndrimit, bashkimin familjar, nënshtetësinë...

...Kanë të drejtë, bashkohem me ta.

...Për mua këto do të shuhen me një ligj, me një dekret presidencial, me hyrjen e Shqipërisë në Bashkimin Evropian....

...Ajo që nuk zgjidhet me asnjë ligj, me asnjë dekret, edhe me hyrjen e Shqipërisë në Bashkimin Evropian, është GJUHA E NËNËS, Gjuha Shqipe. Shqiptarët po humbin identitetin gjuhësor.

"...Fëmijët tuej nuk e mësojnë gluhën e mëmës, nuk kanë disirë të kthenenë në Skipëri, do të bënenë grekër si na..."

Më ka ngelë në vesh e më ka mbet plagë në shpirt kjo frazë e një taksixhiu arvanitas, ndërsa udhëtonim rrugëve të Athinës...

"Shkolla Shqiptare e Athinës", kurset për mësimin plotësues të gjuhës shqipe, në embrionin e ecjes përpara, kërkojnë krahë të fortë, krahë që duhet tu bëhen prindërit, fëmijët, pushteti dhe shteti, Evropa...

Jepuni krahë, jepuni zemër të ecin, të fluturojnë...

(Marrë nga parathënia e librit)



LIBËR KUJTIMI: HOMAZH PËR DJEMTË QË HUMBËN JETËN NË EMIGRACION

"LULET E KURBETIT"

Krahina e Çidhnës, ashtu si edhe krahinat tjera, e priti me shumë dëshirë ndryshimin e madh, rënien e sistemit. Që të gjithë u gëzuam, shpresuam dhe punuam për një jetë më të mirë. Të rinjtë tanë mbushën torbat e bardha me bukë dhe iu drejtuan maleve të Greqisë. Sakrificat e tyre janë të mëdha, të pashembullta dhe të panjohura prej shumëkujt. Nuk kemi në plan të numërojmë vuajtjet e fëmijëve tanë rrugëve të kurbetit, ato tashmë janë bërë pjesë e jetës sonë, i dëgjojmë në mjediset familjare e kudo. Shpeshëherë këto vuajtje kujtohen e tregohen sikur të kishin ndodhë qindra vjetë më parë, por ato që mbeten në mendjen dhe zemrat e njerëzve janë kujtimet për ata që ikën në kurbet por që s'u kthyen kurrë... Ata u nisën drejt së ardhmes me shumë ëndrra dhe për realizimin e tyre punuan e luftuan deri në momentet e fundit të jetës. Nga ditët e para kur filloi rruga e dhimbshme e kurbetit e deri në këto ditë që po shënojmë këto radhë (mars 2009), 59 të rinj nuk janë kthyer pranë familjeve të tyre. Një numër tmerrësisht i lartë për një Krahinë me rreth 13 mijë banorë. 59 djem nga më të mirët e Krahinës, ikën për një jetë më të mirë por u kthyen në arkivole. Për 19 vjet në Krahinën tonë kanë ardhur 59 arkivole nga Italia, Gjermania, Greqia, Anglia, Franca,... e nga s'kanë ardhur. Sa nëna kanë shkulë gjoksin, sa fëmijë kanë mbet jetimë, sa nuse të reja janë vesh në të zeza, sa motra qajnë vëllezërit...Shumë janë. Besoj që secilit nga ju që keni në dorë këtë "libër kujtim", ju ka qëlluar të vëreni se si në çdo gëzim (dasmë etj.) të shihni se më shumë se gjysma e njerëzve janë të veshur në të zeza. Dhe kjo ndodh pikërisht për shkak të këtyre të rinjve që sot nuk jetojnë më. Të gjithë çidhnakët janë të prekur nga plaga e kurbetit.



Dikujt "plumbi" i ka rënë drejtpërdrejt, i ka përshkuar tejembanë zemrën, dikush e ka nëpër trup, se lidhjet miqësore janë të tilla. Duke qenë njëri nga ata njerëz që mbajnë në supe peshën e rëndë të dhimbjes së humbjes së njeriut të dashur, menduam të grumbullojmë jetëshkrimin e të gjithë këtyre djemve në një lidhje-kujtim. Gjej rastin të falënderoj të gjithë ata që u treguan të gatshëm për të kontribuar në grumbullimin e informacionit. Mirëkuptojmë edhe ata që për një arsye a për një tjetër nuk patën mundësi të bëhen pjesë e këtij kontributi, për të rënët në kurbet. Të shkruash dy fjalë për ata që sot nuk jetojnë është detyrë për çdo kënd, për çdo pjesëtar familjeje etj, pasi ata që ikën në lule të rinisë, nuk na kërkojnë asgjë tjetër veç kujtimit e respektit. Për to tashmë nuk nevojitet as shtëpi as fejesë a martesë, asgjë veç një tufë lule tek varri. Edhe ky libër është si një kujtim për ata djem, është si lutje për shpirtin e tyre që të prehen të qetë në botën e përtejme. Në emër të të gjithë prindërve e fëmijëve që ata lanë lutemi" Rahmet u gjet shpirti!

Prej më shumë se një viti jemi përpjekur që të grumbullojmë informacionin e duhur për çdo emigrant çidhnak, të cilët sot nuk jetojnë. Që të gjithë në lulen e rinisë, nga 19 deri 35 vjeç, në moshën më të mirë, ikën atëherë kur u duheshin më shumë se kurrë familjeve të tyre. Ata morën rrugën e kurbetit, me shumë ëndrra për të ardhmen, "hartuan" shumë plane për jetën, për vete e për familjen, por që nuk arritën t'i realizojnë. Pikërisht për këtë dhe në respekt të punës, djersës dhe sakrificës që ata bënë për familjet e tyre, mblodhëm e shënuam këto radhë për secilin prej tyre, duke menduar se kështu ata mbeten paharruar në mendjet e zemrat tona. Gjej rastin t'i falenderoj të gjithë ata prindër, pjesëtarë familjeje apo të afërm të të rënëve, të cilët u treguan të gatshëm dhe kontribuan në përgatitjen e jetëshkrimit të të afërmve të tyre. Për fat të keq jo gjithmonë u arrit ajo që dëshironim. Me gjithë përpjekjet tona, nuk u bë e mundur të sigurohej jetëshkrimi i disa prej emigrantëve të rënë. Jemi shumë të pezmatuar që nuk mundëm që edhe këta të "rreshtoheshin" në këtë libër kujtimi. Kemi qenë të ndërgjegjshëm se i lëndojmë rëndë në shpirt ata nëna e baballarë, kur kemi pyet e folur për të dashurit e tyre që sot nuk jetojnë. Vërtet ua kemi pickuar plagën, por, duke i vendosur gjithë të rënët në këtë libër, çdo njëri nga ne duhet të bindet se nuk është i vetëm, janë edhe 58 të tjerë që vuajnë dhimbjen e plagën e rëndë që kurbeti hapi në zemrat tona. Ndjej keqeardhje për Gëzim Ndrekën, Besim Shehun, Basri Tërshallën, Përparim Bitrin, për të cilët nuk qe e mundur sigurimi i informacionit. Ndërsa për Petrit Hatën, Sokol Hatën, Afrim Krrashin, Sali Kariqin, nuk arritëm të gjejmë mirëkuptimin dhe bashkëpunimin tek të afërmit e tyre. Sidoqoftë, ky libër, le të shërbejë si lutje për shpirtrat e tyre. Ishalla zoti u ka dhënë atyre **PARAJSËN** ndërsa, prindërve, nuseve me të zeza, jetimëve dhe atyre që s'u thahen sytë nga lotët, **forcën për të parë përpara. Amin.**

HAKI PËRNEZHA

Fehmi Kaloshi: Një tezë e re për vendorigjinën e Skënderbeut

(Vijon nga faqja 13)

Gjergj Kastrioti Skënderbeu lindi në Sinjë të Poshtme te Vreshtat në Gardh në vitin 1405 dhe u kthye nga beteja e Nishit në Dibër në vitin 1443." Kastriotët kishin rreth katër breza njerëzorë që jetonin në Sinjë, prandaj ata e ndienin veten dibranë. Por autori thotë që ata në Dibër ishin të ardhur. "Vendorigjinën e Kastriotëve nga krahina e Hasit e Malësisë së Gjakovës na e vërteton edhe dokumenti i mëposhtëm që na e parashtron A. Gegaj", - shkruan autori dhe citon: " Pas kësaj fitoreje, të 22 prillit 1453, Skënderbeu marshoi drejt verilindjes së Shqipërisë dhe pushtoi disa toka midis të cilave, lokalitetin e Gashit, që dikur bënte pjesë në pronat e tij". Dhe autori vazhdon arsyetimin e tij në dobi të pohmit që vendorigjina e Kastriotëve ishte nga Hasi i Malësisë së Gjakovës në Kosovë: " Pra, përderisa Gashi i Malësisë së Gjakovës, apo qoftë edhe Hasi i Prizrenit bënin pjesë në pronat e të parëve të Skënderbeut, kjo...vërteton se vendorigjina e Kastriotëve dhe e Skënderbeut ishte Hasi i Gjakovës, sepse, përndryshe, po të ishin me origjinë nga Sinja e Dibrës, kurrësesi nuk mund të kishin që para vitit 1453 në zotërimin e tyre Gashin në Malësinë e Gjakovës, aq larg Dibrës."

Autori i referohet edhe Barletit, Nolit e shumë autorëve të tjerë, duke u përpjekur që të mbrojë tezën që Kastriotët e kishin origjinën nga Kosova. Autori grumbullon aq shumë të dhëna dhe fakte, sidomos të fushës së etnokulturës, që nuk mund mos të të bëjnë përshtypje që problemi i shtruar, domethënë që Kastriotët e kanë vendorigjinën nga Hasi i Gjakovës në Kosovë, nuk është një lajthitje. Të paktën ka logjikë historike.Fshatrave e lokaliteve shqiptare që prtendojnë ta *kenë të vetin* Skënderbeun, *autori u jep atë që u takon dhe jo cka duan ato*. Në lidhje me këtë ai thotë: "Kosova e priste Skenderbeun si vendorigjina e të parëve të tij, Tetova si nipin e saj, sepse ai ishte nipi i Princit të Pollogut nga e ëma, Voisava Tribalda. Dibra e priste si birin e saj, sepse ai kishte lindur në Gardh të Sinjës së Poshtme, Kruja e gjithë Shqipëria e prisnin, sic shkruante Barleti, si Shpëtimtarin e Lirisë."

Autori hap pas hapi krijojnë një përfytyrim të plotë e të qartë, duke hapur brazdën për të shkuar tek Hasi i Malësisë së Gjakovës dhe për ta kërkuar aty vendin e origjinës së Kastriotëve. Për mbrojtjen e kësaj teze autori ka sjellë argumentet e veta. Ndokujt mund të mos i duken bindëse dhe, për rrjedhojë, nuk i mbushet mendja se vendi i origjinës së Kastriotëve është Hasi i Gjakovës në Kosovë. Por vetvetiu lind pyetja : cilat nga tezat që lidhet me Kastriotët dhe Skënderbeun nuk të lë pikë dyshimi për vërtetësinë e saj? Fakti që për të njejtin problem (edhe për origjnën e Kastriotëve) ka mendime nga më të ndryshmet, e dëshmon plotësisht një gjë të tillë. Nisur nga sa thashë nuk kemi pse përfundimin e F. Kaloshit ta anatemojmë. i parë nga ky kënd, libri i Fehmi Kaloshit, të paktën si qëndrim i ri, duhet marrë në konsideratë. Qëndrimet ndryshe i interesojnë shkencës sepse nuk ka zhvillim në asnjë fushë pa debate dhe të kundërta. R. Luksemburgu thoshte se: "Liria është, në radhë të parë, liri për atë që mendon ndryshe". Vetëm sikur këtë meritë t`ia njohim librit të Fehmi Kaloshit, duhet ta përshëndesim. Por këtë gjë nuk e bëri asnjë nga historianët tanë. Këtë e vërtetoi edhe promovimi i këtij libri: megjithëse patën të gjithë ftesa dhe nga një kopje të librit, asnjë prej historianëve dhe akademikëve nuk erdhi në këtë promovim. Ky qëndrim mohues dhe përjashtues tregon se historianët tanë i japin vlera vetëm vetes, por, kur shikon historinë e kombit tonë të shkruar, nuk të mbushet mendja që kanë kaq shumë vlera.

Xh. Martini

Gazetën, falë ndihmës së z. Gazmend Kërkuti, mund ta lexoni edhe në internet në adresën: www.dibra.org